



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË

Numri i Ceshtjes : 21234-01750-61-2022 **Data e Regjistrimit :** 20/06/2022
Numri i Vendimit: 61-2022-4632 **Data e Vendimit :** 03/11/2022

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË E
PËRBËRË NGA:**

GJYQTAR: Enkel Peza

SEKRETARE: Blerina Brahim

Sot më datë 03/11/2022mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile që i përket :

Paditës Aleks Ceca, i biri i Zef dhe i Mire, i datëlindjes 26/10/1983 I Paditur OSSH I Paditur Shoqeria e Furnizuesit te Tregut te Lire I Paditur FSHU I Paditur O.SH.E.E

Objekti:Shperblim demi jo pasuror (biologjik, moral dhe ekzistencial)per paditesin Aleks Ceca per shkak te vdekjes se shtetasit Prend Ceca

Baza Ligjore:Neni 154/a/1 K.PR.C

x

VEREN :

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORË

Nr. Regj. Themeltar. 1555
Datë 20.06.2022 Datë 03.11.2022

Nr. 768 Vendimi

VENDIM

“NE EM?R T? REPUBLIK?S”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e p?rb?r? nga:

GJYQTAR: ENKEL PEZA

asistuar nga sekretare gjyqësore **Blerina Brahimi**, sot n? dat? **03.11.2022** përfundoi shqyrtimin n? seanc? gjyq?sore me dyer t? hapura të ç?shtjes civile nr. **1555** akti, q? ju p?rket pal?ve:

PADITËS/N/KRYESORË: Aleks Ceca, i biri Zef dhe Mire, i dtl. 25.10.1983, lindur në Iball, Pukë dhe banuese në Vlorë.

Jani Ceca, i biri Zef dhe Mire, i dtl. 05.04.1982, lindur në Burgjon, Pukë dhe banuese në Vlorë.

Pjerin Ceca, i biri Zef dhe Mire, i dtl. 25.07.1980, lindur në Burgjon, Pukë dhe banuese në Vlorë.

Përparim Ceca, i biri Zef dhe Mire, i dtl. 28.07.1986, lindur në Iball, Pukë dhe banuese në Vlorë.

Të gjithë të parfaqësuar nga Av. Ardian Dauti dhe Av. Gimi Paja me prokurë.

TË PADITUR : Shoqëria “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sha me NIPT K72410014H, (OSHEE). Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88, H. 1, Kati V, Njësia Administrative Nr. 7, 1023.

Shoqëria “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sha me NIPT L81530018E, (OSSH). Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88, H. 1, Kati V, Njësia Administrative Nr. 7, 1023.

Shoqëria “Furnizuesi i tregut të lirë” sha. (FTL) me NIPT L81530029T, Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88, H. 1, Kati V, Njësia Administrative Nr. 7, 1023.

Shoqëria “Furnizuesi i shërbimit universal” sha; (FSHU) me NIPT L81530016L, Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88, H. 1, Kati V, Njësia Administrative Nr. 7, 1023.

Të gjithë të parfaqësuar nga Juristi Ardi Hysaj i pajisur me autorizime.

PËRSON I INTERESUAR : Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Vlorë, (AVSh), prezent Av. Gjergji Arizaj.

OBJEKTI: Shpërblimin e dëmi jo-pasuror (moral dheekzistencial) për paditësin Aleks Ceca për shkak të vdekjes së shtetasit Prend Ceca në aksidentin e datës 24.02.2019 në vlerën e 12.000.000 lekë;

Shpërblim dëmi jo-pasuror (moral dheekzistencial) për ndërhyrësat kryesorë/paditës Pjerin Ceca, Jani Ceca dhe Përparim Ceca për shkak të vdekjes së shtetasit Prend Ceca në aksidentin e datës 24.02.2019 në vlerën 12.000.000 lekë secili.

Detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të paditësit dhe ndërhyrës kryesorë/paditës kamatat ligjore të shumës së dëmshpërblimit nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë deri në ditën e ekzekutimit të vendimit prej përmbaresit gjyqësor.

Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm;

Detyrimin e palës së paditur për të paguar pagesën e taksaveshpenzimeve gjyqësore dhe avokatore.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 102, 154, 156, e vijues, të Kodit të Procedurës Civile; Kodi Civil 608, 609, 618, 622 e vijues të K. Civil dhe 126, 306-310, 317 e vijues të K.Pr.Civile; Vendimit Unifikues Nr.12/2007 të Gjykatës së Lartë.

Gjykata, pasi administroi provat e shqyrtuara gjat? procesit gjyq?sor;

- dëgjoi pretendimet përfundimtare të Avokatit t? paditësve i cili kërkoi: “...Pranimin e kërkesë-padisë sipas objektit të ndryshuar...”

- prapësimet e përfaqësuesit të padituritve (OSHEE), (OSSH), (FTL); (FSHU) i cili u paraqit gjatë bisedimeve përfundimtare dhe dorëzoi pretendime me shkrim dhe kërkoi: “...Rrëzimin e kërkesë-padisë...”

- Avokati i Shtetit i Zyrës Vendore e Avokaturës së Shtetit Vlorë i cili u paraqit gjatë bisedimeve përfundimtare dhe dorëzoi pretendime me shkrim dhe kërkoi: “...Rrëzimin e kërkesë-padisë...”

VËREN:

Paditësi **Aleks Ceca** kanë paraqitur fillimisht para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë një kërkesëpadi, kundër të paditurit (OSHEE), (OSSH), (FTL); (FSHU) me objekt: “Shpërblimin e dëmi jo-pasuror (moral dheekzistencial) për paditësin Aleks Ceca për shkak të vdekjes së shtetasit Prend Ceca në aksidentin e datës 24.02.2019. Detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të paditësit kamatat ligjore të dëmshpërblimit nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë deri në momentin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nga ana e shërbimit përmbare sipas normës së Bankës së Shqipërisë. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Detyrimin e palës së paditur për të paguar pagesën e taksave shpenzimeve gjyqësore dhe avokatore...”

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesëpadisë, Gjykata konstatoi se në bazë të neneve 35, 36(1), 41, 45 të Kodit të Procedurës Civile, çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga palët nuk pati pretendime për juridiksionin apo kompetencën e gjykatës.

Bazuar në parashikimet e nenit 79/a të K.Pr.Civile, kërkesë padia dhe aktet ju njoftuan dhe Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Vlore, ne gjykim u paraqit avokati i shtetit.

Nga paditësi dhe nga ndërhyrësit kryesor Pjerin, Jani dhe Përparim Ceca u bë kërkesë për saktësimin e objektit të padisë pasi ishte kryer dhe pagesa e taksës.

Gjykata urdhëroi kalimin e çështjes në seancë përgatitore bazuar ne nenin 158, 158/b, K.Pr.Civile për tu shprehur për kërkesat. Pasi dëgjoi palët gjykata vendosi me vendim te ndërmjetëm të pranojë kërkesën bazuar ne nenet 158/b, 189, 190 e vijues K.Pr.Civile nga ndërhyrësit kryesor (nga këtu e në vazhdim paditës) Pjerin, Jani dhe Përparim Ceca. Gjatë seancës përgatitore ju njoftua palëve kërkesa për saktësimin e objektit te padisë, dhe pasi mori mendimin e paleve të paditura dhe AVSh, bazuar ne nenin 185 te K.Pr.Civile gjykata vendosi pranimin e kërkesës për saktësimin e objektit.

Gjatë veprimeve përgatitore u paraqit kërkesë nga paditësit për marrjen e provës me ekspert. Gjykata pasi mori mendimin e palëve vendosi të pranojë kërkesën dhe me vendim caktoi ekspertet. Gjykata pasi u njoh me faktin se një nga ekspertët, dhe konkretisht eksperti Alfred Hasanaj kishte papajtueshëri për të qene ekspert në këtë çështje (ishite shprehur për faktin në prokurori, ku kishte qene pjesë e grupit të ekspertimit) vendosi revokimin pjesërisht të urdhërit për caktim eksperti dhe akti i ekspertimit u krye nga dy ekspertët e tjerë. Pasi u paraqiten ekspertet, bënë betimi nga palët e sugjeruan detyrat nga palët. Gjykata vendosi të pranojë sugjerimet e paleve pa përjashtuar asnjeren prej tyre dhe ekspertëve ju caktuan detyrat me vendim të gjykatës. Pasi realizuan aktin e ekspertimit akti ju njoftua paleve dhe palët e paditura dhe avokatua e shtetit bënë pyetje në lidhje me aktet e ekspertimit dhe ekspertet ju përgjigjën pyetjeve.

Gjatë seancës përgatitore ju njoftua palëve kërkesa për shtimin e objektit te padisë, dhe pasi mori mendimin e paleve të paditura dhe AVSh, bazuar ne nenin 185 te K.Pr.Civile gjykata vendosi pranimin për shtimin e objektit të kërkesëpadisë. Objekti i kërkesëpadisë përfundimisht është: “Shpërblimin e dëmi jo-pasuror (moral dheekzistencial) për paditësin Aleks Ceca për shkak të vdekjes së shtetasit Prend Ceca në aksidentin e datës 24.02.2019 në vlerën e 12.000.000 lekë; Shpërblim dëmi jo-pasuror (moral dheekzistencial) për ndërhyrësat kryesorë/paditës Pjerin CECA, Jani CECA dhe Përparim CECA për shkak të vdekjes së shtetasit Prend CECA në aksidentin e datës 24.02.2019 në vlerën 12.000.000 lekë secili. Detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të paditësit dhe ndërhyrës kryesorë/paditës kamatat ligjore të shumës së dëmshpërblimit nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë deri në ditën e ekzekutimit të vendimit prej përmbaresit gjyqësor. Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm; Detyrimin e palës së paditur për të paguar pagesën e taksaveshpenzimeve gjyqësore dhe avokatore.”

Bazuar në parashikimet e nenit 35 të K.Pr.Civile çështja u mor në shqyrtim nga trup gjykues i përbërë nga një gjyqtar pasi vlera e kërkesëpadisë sipas objektit të kërkesëpadisë së shtuar të paditësve në seancë përgatitore nuk e kalon shumën 50 milion lekë. Pasi nuk kishte më veprime përgatitore sipas nenit 158/b gjykata mori vendim për caktimin e provave dhe urdhëroi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore bazuar në nenin 158/c të K.Pr.Civile. Ky vendim ju njoftua palëve në seancë.

I. Rrethanat e Faktit.

Paditësi **Aleks Ceca** dhe paditësat/NKryesorë **Pjerin, Jani** dhe **Përparim Ceca** janë vëllezërit e të ndjerit Prend Ceca, bazuar në certifikatat familjare.

Në datën 24.02.2019 në lagjen "Ndërmillas" fshati Fierzë, njësia Administrative Fierzë Bashkia Fushë Arrëz, shtetasi i ndjerë Prend Ceca ka shkuar pranë shtyllës që i përket fiderit të "Iballës" për të riparuar dhe rregulluar linjën dhe si pasojë e kontaktit me energjinë elektrike ka ndëruar jetë në vend.

Për këtë ngjarje nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Pukë është nisur procedimi penal Nr. 22 i vitit 2019, duke hetuar shkaqet e ndodhjes së kësaj ngjarje që kanë të bëjnë me humbjen e jetës së shtetasit Prend Ceca.

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Pukë janë kryer një sërë veprimesh hetimore dhe janë administruar një sërë provash shkresore si dhe akt ekspertimi mjeko ligjorë.

Prokuroria e Rrethit Pukë në përfundim të hetime dhe pas administrimit të aktit teknik i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Pukë me: "Kërkesë për gjykimin e procedimit penal Nr 22/2019" për veprën penale të "Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë" si pasojë e vdekjes së të ndjerit Prend Ceca.

Paditësit, duke pretenduar se veprimet dhe mosveprimet me faj të palëve të paditura (OSHEE), (OSSH), (FTL); (FSHU) në gjykim atyre i kanë shkaktuar dem jashtekontraktor jopasuror, paditësit i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë padinë objekt gjykimi, me palë, objekt dhe bazë ligjore, cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

II. Pretendimet e palëve.

A. Përfaqësuesi I paditësve kërkoj pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit dhe në mënyrë të përmbledhur pretendoi se:

- Palet kane legjitimitet aktiv dhe pasiv.

- Pala e paditur, Shoqëria "OSHEE" sh.a, dhe punonjësi i sajë Vladimir Vila bazuar në provat shkresore të hetimit të çështjes pranë Prokurorisë së Rrethit Pukë, akti ekspertimit elektrik të kryer me grup ekspertësh, marë në hetimet paraprake, ka rezultuar duke u provuar katërcipërisht shkak pasoja, pra përgjegjëse nga ana civile dhe penale për ndodhjen e faktit të paligjshëm humbjen e jetës së të ndjerit Prend Ceca, janë pikërisht veprimet dhe mosveprimet e palës së paditur e cila kishte detyrim ligjor që të zbatonte Rregulloren e Sigurimit teknik duke siguruar jetën dhe shëndetin e njerëzve.

-Nga ana e palës së paditur janë shkelur ligji dhe Rregullat e Sigurimit dhe shfrytëzimit Teknik në Punë.

- Nga administrimi në gjykim i aktit të ekspertimit të hartuar nga eksperti i dëmeve shëndetësore, vlera monetare e dëmit jo-pasuror që kanë pësuar paditësit dhe N/kryesorë paditësa, për shkak të humbjes së jetës të shtetasit Prend Ceca, janë llogaritur dhe kërkojmë sipas dëmshpërblimit sipas aktit të ekspertimit në vlerën maksimale të dëmit.

- Në lidhje me dhënen e vendimit të gjykatës me ekzekutim të përkohshëm pasi paditësit janë në vështirësi ekonomike.

B. Përfaqësuesi I të paditurve dhe AVSh (përafërsisht të njëjtat prapsime) kërkuan rrëzimin e kërkesëpadisë sipas objektit dhe në mënyrë të përmbledhur prapsuan se:

-Për palet e paditura (OSHEE), (FTL); (FSHU) janë shoqëri të krijuara pas vitit 2020 dhe duhet të pushohet gjykimin.

- I padituri në këtë proces është një shoqëri, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me kuadrin ligjor rregullues të fushës ku operon. Pala e paditur OSHEE Sh. a në këtë gjykim, nuk ka legjitimitet pasiv, pasi nuk mund të detyrohet të dëmshpërblejë paditësat sepse nga ana e palës së paditur nuk është kryer asnjë veprim i paligjshëm dhe me faj që të ketë shkaktuar pasojën e ardhur, dëmtimin e shtetasit Prend Ceca.

- Nga analiza e akteve të administruara në dosjen gjyqësore rezulton se ngjarja ka qenë aksidentale dhe shkelja e normave të sigurisë nga vete viktimat. E evidentojmë këtë fakt pasi në kuptim të neneve 608 dhe 609 të Kodit Civil, që të ekzistojë përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, duhet të ekzistojë lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit të paligjshëm dhe pasojës së ardhur. Gjithashtu neni 13 i Kodit Penal parshikon se "...", mungon lidhja shkakësore.

Në bazë të Nenit 608 të Kodit Civil, ekzistenca e përgjegjësisë civile, është e lidhur ngushtësisht me vërtetimin e lidhjes shkakësore. Në bazë të Nenit 608 të Kodit Civil dëmi i shkaktuar duhet të jetë rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit apo mosveprimit. Në këtë rast, pra në rastin e marrëdhënieve jashtekontraktore, veprimi dhe pasoja duhet të vijnë menjëherë njëri pas tjetrit pa patur shpëputje në kohë. Pra sipas dispozitave që cituam më sipër, vërtetimi i lidhjes shkakësore është kusht thelbësor për pranimin e përgjegjësisë civile dhe penale.

- Është lehtësisht e evidentueshme se në këtë rast mungon lidhja shkakësore, veprimit ose mosveprimit të paligjshëm dhe me faj e strukturave të Shoqërisë "OSHEE" dhe pasojës ardhur (vdekjes së shtetasit Prend Ceca), sepse shkak kryesor i ndodhjes së aksidentit me vdekje është shkelje e cila është bërë nga vete viktimat i cili me vullnetin e tij ka shkuar pranë shtyllës duke punuar në të.

Pra në këtë situatë jemi para rastit "klasik" të ndërprerjes së lidhjes shkakësore. Vlen të theksojmë se këtë qëndrim mbajnë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës Së Lartë në Vendimin Unifikues nr. 12, datë 14.09.2007, në paragrafin I, 2, 3, 4 dhe 5 të pikës 4 të tij, në të cilin percaktohet: "...". Nga tërësia e rrethanave, dispozitave ligjore, si dhe praktikës gjyqësore unifikuese, që parashtruan më sipër rezulton e provuar se kërkimi i paditësit për dëmshpërblim është i pabazuar.

- "Demi jashtekontraktor", i pretenduar nga pala paditëse, parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë. Në interpretim të kësaj dispozite, për të vërtetuar se nga ana e veprimeve apo mosveprimeve tona, i është shkaktuar dëm jashtekontraktor, duhet detyrimisht të vërtetohet nga ana e palës që pretendon se është dëmtuar, kryerja e veprimeve tona në mënyrë të paligjshme dhe me faj. Bazuar në argumentat e sipërcituara, ky pretendim rrëzohet tërësisht. Sipas dispozites 608 e vijues të K.Civil, përgjegjësia e dëmit mund të dalë pasi të kenë konkuruar katër elementet e shkaktimit të dëmit; (i) Ekzistenca e dëmit; (ii) lidhja shkakësore; (iii) veprimi ose mosveprimi; (iv) faji. Në rastin tonë, nuk ka asnjë prej elementeve të mësipërme që mund të lidhet me veprimet e të paditurit dhe në këtë kuptim mungon legjitimitet pasiv i OSHEE sh.a. në këtë çështje. Në nenin 609 të K.Civil, percaktohet se: "...". Pra, për pranimin e përgjegjësisë civile jashtekontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) të

përgjegjesisë civile jashtëkontraktore, duhet të vërtetohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes (veprimet a mosveprimet) të paligjshëm e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Në vijim, për përcaktimin e dëmtimeve (cënimeve) konkrete që rrjedhin nga ky fakt i paligjshëm dhe caktimin e dëmshperblimit përkatës, duhet të vërtetohet dhe lidhja shkakësore juridike ndërmjet tyre.

Nëpermjet lidhjes shkakësore materiale, vërtetohet se cili është personi përgjegjës (subjekti aktiv) dhe lidhja shkak—pasojë ndërmjet tre elementeve objektive e subjektive të faktit të paligjshëm (ngjarjes së dëmit), sjelljes së paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojës së ardhur prej tyre, pra dëmtimit të një tjetri në personin a pasurine e tij (objektiv).

Nga ana e paditësve gjithë faktet dhe rrethanat që lidhen me procedimin penal të sjella si prova kanë konkluduar në arritjen e konkluzionit se veprimet apo mosveprimet të kryera në formën e neglizhencës apo vetbesimit të tepruar të personave të cilët punojnë për llogari të subjektit juridik konkretisht shoqërisë OSHEE sh.a është vet personi (punonjësi i OSHEE Group sh.a) përgjegjës për veprimet e tyre individuale duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.9754, datë 14.6.2007, duke ngarkuar dhe fajësuar pa të drejtë punëdhënësin OSHEE sh.a.

Pra në pjesën arsyetuese të njoftimit për perfundimin e hetimeve në mënyrë të gabuar veprimet apo mosveprimet e kryera nga punonjësit e OSHEE sh.a si nga viktimat dhe punonjësit tjetër Vladimir Vila i ngarkohen punëdhënësit OSHEE sh.a duke eliminuar një fakt të rëndësishëm se ato janë veprime tërësisht personale të ndërmarra me inisiativën e vetë punëmarresve për të cilat ata duhet të mbajnë përgjegjësi personale nëse do të vërtetohen sipas procedimit penal nga aktet dhe vendimet që do të dërgohen nga organet e drejtësisë për të cilat jemi në pritje për të plotësuar mbrojtjen tonë.

Në këtë rast ardhja e pasojës së dëmshme nuk do të vërtetohet, nëse nuk do të kishte ndodhur shkak, veprimi i neglizhent i të dëmtuarit, në mosmarrjen e masave për respektimin e rregullave të sigurimit nga i ndjeri për të cilat ishte i informuar që në kontratën e punës. Janë pikërisht këto veprime të të ndjerit, që kanë shkaktuar pasojën për të cilin paditësat kërkojnë shpërblimin e dëmit.

Njëkohësisht, rregullat e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për punën në linjat apo pajisjet që kanë tension elektrik, janë të përcaktuara qartë edhe në "Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike" miratuar me Vendimin Nr. 148 datë 09.12.1967 të Këshillit të Ministrave.

Kjo rregullore në përmbajtje të saj përcakton rregulla të cilat shërbejnë për parandalimin e aksidenteve në punë për personelin që punon, shërben apo kryen punime në pajisjet apo instalimet elektrike. Zbatimi në mënyrë korrekte i termave të kësaj rregulloreje në mënyrë të detyrueshme dhe pa lejuar asnjë shkelje të saj është dhe elementi bazë për të evituar rrezikshmërinë e jetës dhe shëndetit të çdo punonjësi. Përcaktimet këto të bera dhe në termat e përgjithshme të kësaj rregullore. Sa me sipër, edhe në këtë këndvështrim, nuk provohet se OSHEE sh.a, ka kryer ndonjë veprim të paligjshëm e me faj në ardhjen e pasojës dhe nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për shpërblimin e dëmit, aq më tepër i ndodhur nën vullnetin e viktimës dhe në mosrespektim të asnjë pike të sigurisë në punë (referohu rregullave të sigurimit teknik)

Nga gjithë veprimet hetimore të kryera nga organi akuzues nuk gjendet ndonjë urdherese e punëdhënësit që të ketë ndikuar direkt apo indirekt në veprimet apo mosveprimet e ndërmarra nga punëmarresit e shoqërisë OSHEE sh.a.

Sikurse rezultoi punëmarresit i ndjeri Prend Ceca dhe punonjësi tjetër Vladimir Vila kanë qenë njohës të mirë të Rregullores së Sigurimit Teknik për të cilën janë dhe certifikuar për çdo vit për këto njohuri ku i ndjeri Prend Ceca gezonte Grupin III të Sigurimit Teknik ndërsa Vladimir Vila gezonte Grupin IV të Sigurimit Teknik, nga subjekte të miratuara për certifikimin e njohurive mbi rregullat e sigurimit teknik për pajisjet elektrike nën tension sic është shoqëria HTM shpk.

Gjithashtu njohja e Rregullores së Sigurimit Teknik është pjesë e përkohshme të punës dhe është detyrim ligjor njohjeje si punonjës me specifikime teknike të veçanta për shkak të profilit të punës. Ashtu sikurse thamë më lart i ndjeri dhe kolegu i tij kishin dënuar dhe ishin testuar për këto njohuri mbi rregullat e sigurimit teknik madje në mënyrë vjetore.

Njëkohësisht vëmë në vëmendje tuaj se ndërmjet palës sone të paditur dhe viktimës të ndjerit Prend Ceca kemi qënë përpara lloj marrëdhënie kontraktuale pune, e cila gjendet rregullin mbi përcaktimet ligjore të Kodit të Punës. Kështu Kodi i Punës ka bërë rregullimin dhe të situatave të cilat lidhen me dhënien apo me zbatimin e një urdhri të dhënë nga punëdhënësi i cili ndikon direkt apo indirekt në jetën dhe shëndetin e punëmarresit. Nëne 23 përcaktohet se: "...". Në rastin tonë konkret nuk kemi ndonjë urdher që të ketë ndikuar apo sjell aksidentin me pasojë vdekjen e punëmarresit Prend Ceca për të cilën subjekti juridik OSHEE Group sh.a duhet të ngarkohet me faj. Sikurse vërehet dita në të cilën ka ndodhur aksidenti data 24.02.2019 në kalendarin vjetor 2019 rezultoi ditë e diel dite pushimi zyrtar. Në këtë datë sipas parashkrimeve të bera në Njoftim "Për perfundim të hetimeve" nga ana e organit të akuzës nuk raportohet ndonjë urdher nga eprori për daljen në punë për ndonjë rast emergjence. Pra kjo konfirmon faktin që veprimet janë marre me vendim dhe përgjegjësinë e tij personale që mund të jete bërë për shkak që konsistojnë në nderhyrje të parregullta dhe për qëllime joligjore.

Gjithashtu në aktin e ekspertimit të mbajtur nga Ing.Spiro Llusha 9 faqe bashkelidhur deklarates për këtë ngjarje që do të gjeni pjesë të provave mbajtur nga OSHEE Group sh.a janë evidentuar shkeljet që përbejnë shkakun e aksidentit të cilat janë përcaktuar në Rregullores së Shfrytëzimit teknik për Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike.

Shkak i tjetër i rënies në tension të elektricitetit viktimat (Pred Ceca) ka qenë dhënia e tensionit (elektrike) magjstralit kryesor të linjës së TM të fiderit të iballes, pjesës nga nënstacioni 110/10 Kv "Gropaj" deri tek ndaresi thike në fshatin Gralisht (i cili ishte i stakuar) pra të vendit të punës (përcjellesave të zhveshur të linjës TM) mbasi elektriciteti (viktimat) Pred Ceca kishte disa kohe duke punuar në majë të shtyllës së drurit i lidhur me rrypë sigurimi në linjën TM pa tension.

- Për kërkimin e palës paditëse në lidhje me ekzekutimin e përkohshëm: Me këtë kërkesë të palës paditëse nuk jemi dakord, pasi vjen në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe konkretisht me kriteret e përcaktuara në nenin 317 e vijues i K.Pr.Civile Pala paditëse e ka kërkuar dhënien e ekzekutimit të përkohshëm pa ju përmbajtur dispozitës së K.Pr.Civile. Nuk u paraqit asnjë provë, asnjë fakt apo rrethanë që të vërtetojë atë cka paditësi ka pretenduar në lidhje me ekzekutimin e përkohshëm në referim të 317 K.Pr.C. Paragrafi i parë i këtij neni nuk përmbushet pasi nuk jemi në kushtet e detyrimit për ushqim, për shpërblim nga puna apo për rivendosje në posedim të banesës bashkëshortore. Ndërsa sa i përket paragrafit të dytë të nenit 317, pala është e detyruar të paraqes prova. Pra nga i gjithë ky interpretim

del qartë që rasti në fjalë nuk përfshihet në asnjë nga kategoritë e permendura në nenin 317 të K.Pr.C., pasi nuk jemi në rastin e kategorisë së parë për shpërblim nga puna, detyrimin ushqimor dhe as për rivendosjen në posedim të banesës bashkeshortore. Gjithashtu nuk jemi as në kategorinë e dytë ku për të cilën në asnjë rast nga ana e palës paditëse nuk u paraqitën prova që të vërtetohej se ekzekutimi i vendimit mund të bëhet i pamundur (theksojmë se shoqëria OSSH SH.A është një ent publik me kapital 100% shtetëror me një adresë të përcaktuar qartë, me likuiditete të ekspozuara në të gjitha bankat e nivelit të dytë). Nga ky këndvështrim OSSH SH.A në asnjë rast nuk mund të bëhet pengesë për ekzekutimin e vendimit në rastet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, historiku i saj ka treguar qartë se në asnjë rast nuk është bërë pengesë për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të drejtë.

- Paditësi ka kërkuar në padi edhe kamatë-vonesat nga data e paraqitjes së padisë. Sa i përket këtij pretendimi, na lejoni të citojmë Nenin 450 të Kodit Civil. Nga interpretimi i kësaj dispozite kërkohet një debitor në vonesë për të kërkuar kamatat e arrira, prej datës së fillimit të vonesës së debitorit. Në rastin tonë nuk kemi të njohur ndonjë palë debitore, e cila të ketë vonuar pagesën e një shume parash. Sa më sipër kërkimet e paditësit në kërkesë-padi, janë kërkime të pabazuara në prova dhe në ligj dhe si të tilla ato duhen rrëzuar.

- Gjykata me vendim të ndermjetem vendosi që të therrase në cilesine e eksperteve tre ekspert të fushave të ndryshme. Dhe perkatesisht tre ekspert Ing. Elektrik, nje ekspert Vleresues Demesh si dhe nje ekspert Psikolog. Pavarsisht se ne si pale e paditur e kundersh tuam thirrjen e eksperteve me arsyetimin se nuk ekziston asnje prove shkresore qe te vertetoje qe jemi ne pergjegjes si OSHEE SH.A, dhe ndaj nuk eshte e nevojshme te caktohen ekspert. Aktet e ekspertimit i kundershtojme dhe nuk jemi dakord.

III. Baza Ligjore dhe arsyetimi i gjykatës.

Kodi Civil Neni 608 "**Përgjegjësia për shkaktimin e demit**" parashikon se: "*Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkakuar. Personi që ka shkakuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.*

Neni 609 parashikon se: "*Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkakuar.*"

Neni 610 parashikon se: "*Është e pavlefshme marrëveshja që paraprkishtë përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj.*"

Neni 611 parashikon se: "*Nuk është përgjegjës ai që i shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një të treti.*"

Neni 612 parashikon se: "*Personi që ka shkakuar dëmin duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar veten ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkakuar dhe as nuk mund të mënjanohet prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit.*"

Neni 622 K. Civil parashikon se: "*Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e demit.*"

Kodi i Punës neni 39 parashikon se: "*1. Punëdhënësi për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet, profesionale duhet të përcaktojë qartë rregullat e sigurimit teknik. 2. Punëdhënësi, duhet të paguajë diferencën midis dëmit dhe shpërblimit që merr punëmarrësi nga sigurimet shoqërore, kur aksidenti ose sëmundja profesionale është pasojë e fajësisë së rëndë të punëdhënësit. 3. Kur punëdhënësi nuk ka regjistruar punëmarrësin në sigurimet shoqërore, ai duhet të përballojë të gjitha shpenzimet që ka bërë punëmarrësi si rezultat i aksidentit ose sëmundjes profesionale, si dhe të gjitha dëmet si pasojë e mosregjistrimit.*"

Neni 40 parashikon se: "*1. Punëdhënësi detyrohet të kujdeset për higjienën e vendeve të punës. Punëdhënësi pasi konsultohet me punëmarrësit, duhet të marrë masat e nevojshme mbrojtëse kundër rreziqeve të veçanta që paraqesin substancat dhe agjentët helmues, makinat, transporti i peshave të rënda, ndotja e ajrit, zhurmat dhe dridhjet, si dhe rreziqeve në disa degë të ekonomisë, si ndërtim, xhenio civile, miniera dhe industri kimike. Punëdhënësi duhet të vendosë sinjale të dallueshme qartë në çdo vend pune, që paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve. 2. Kur natyra e punës paraqet rreziqe të veçanta për jetën dhe shëndetin e punëmarrësve, sipas pikës 1, të këtij neni, punëdhënësi organizon, me shpenzimet e tij, në mënyrë periodike, si dhe sipas këshillimit të mjekut të ndërmarrjes, vizita mjekësore profesionale dhe ekzaminime mjekësore shtesë të punëmarrësit, para marrjes në punë dhe gjatë marrëdhënies së punës. 3. Masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*"

Ligjit 10 237 datë. 18.02.2010 "Për Sigurimin dhe shëndetin në Punë" Neni 11 parashikon se: "*1. Punëdhënësi, për garantimin e zbatimit të masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, ka këto detyrime: a) siguron dhe kontrollon cilësinë e kryerjes së shërbimeve të personave përgjegjës ose të shërbimeve të jashtme të kontraktuara prej tij për sigurinë e shëndetin në punë, në mënyrë që të gjithë punëmarrësit të dinë dhe të zbatojnë masat e parashikuara në dokumentin e vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut, të përcaktuar në shkronjën "b" të nenit 10 të këtij ligji; b) merr masat për të siguruar materialet e nevojshme për informimin dhe trajnimin e punëmarrësve, si për shembull postera, fletushka, filma, filmime të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë; c) siguron informimin e çdo personi përpara fillimit të punës, për rreziqet ndaj të cilave ai mund të ekspozohet në vendin e punës, si dhe për masat parandaluese dhe mbrojtëse që nevojiten;...*"

IV. Arsyetimi i Gjykatës.

Gjykata, në analizë të këtyre pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, provave të paraqitura prej tyre, si dhe parashikimeve ligjore, çmon se kërkimet e paditëses janë pjesërisht bazuara. Në vijim do t'i analizojmë ato, duke u shprehur në mënyrë të veçantë për bazueshmërinë në ligj dhe prova të secilit prej tyre.

Së pari: Për sa i përket legjitimitetit aktiv: Paditësit/ndërrësit **Aleks, Pjerin, Jani dhe Përparim Ceca** kanë legjitimitet aktiv, pasi nga ngjarja e ndodhur paditësit/ndërrësit kryesor kanë pësuar një dëm të rëndë në shëndetin e tyre për shkak të humbjes së familjarit të tyre (vëllait) Prend Ceca, dem i cili është pasuar dhe nga dëmet e tjera të natyrës jo pasurore. Në keto kushte, referuar praktikës unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara, të cilat shprehen: "*...Çdo subjekt i cënuar në të drejta dhe interesa të ligjshme personale e pasurore nga fakti i*

paligjshëm, edhe nëse nuk është ai vetë subjekti pasiv i atij fakti, ka të drejtën subjektive, legjitimimin aktiv, për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar. Ky legjitimim aktiv, në parim, nuk kushtëzohet me gëzimin e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vetë paditësit si i dëmtuar nga fakti i paligjshëm", si dhe K.Pr. Civile neni 32, i cili parashikon: "Padia mund të ngrihet: a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur; b) për vërtetimin e qenies ose mosqenies së një marrëdhënieje juridike ose një të drejte; c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasojë juridike për paditësin", paditësi dhe ndërhyrësit kryesorë kanë legjitimitet aktiv për të ju drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

Sa i përket legjitimitet pasiv: Gjykata çmon se, ndryshe nga sa ajo që u pretendua ne gjykim, palët e paditura (OSHEE), (OSSH), (FTL); (FSHU) kanë legjitimitet pasiv. Pasi janë keto të fundit që me veprime dhe mosveprime, kanë shkakuar dëmin me pasojë humbjen e jetës së të ndjerit Prend Ceca. Secili nga të paditurit kanë personalitet juridik më vete dhe janë të regjistruara si shoqëri tregtare me vete.

Së dyti, nga palët nuk u ngriten pretendime dhe as gjykata nuk konstaton se ndodhemi përpara kushteve të neneve 611 dhe 612 që të përjashtohen palët nga përgjegjësia për dëmin dhe në keto kushte gjykata merr ne analize nenin 608 të K.Pr.Civile.

Së treti, ne interpretim të nenit 608 e vijues të Kodit Civil, për të lindur detyrimi nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor duhet të plotësohen ne mënyre kumulative këto kushte:

- (i) **ekzistenca e dëmit;**
- (ii) **paligjshmëria e veprimit ose mosveprimit;**
- (iii) **lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur;**
- (iv) **dhe, fajësia e personit që ka shkaktuar dëmin.**

a) Veprimi ose mosveprimi i paligjshëm ne shkaktimin e dëmit cilësohet një kategori objektive, shfaqja e kundraligjshme e vullnetit të subjektit të drejtës që sjell si pasojë shkeljen ose cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave të tretëve, që mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira.

a) Faji është qëndrimi subjektiv i personit shkaktar të dëmit ne raport me veprimin e kundraligjshëm dhe pasojat që vijnë prej tij, që nënkupton vullnetin e brendshëm psikik për të kryer veprimin, për të siguruar ardhjen e pasojave ose lejin e ardhjes së tyre.

c) Lidhja shkakësore vlerësohet si ekzistenca e lidhjes objektive, të drejtpërdrejte dhe të pavarur nga vullneti i subjektit shkaktar të dëmit mes veprimit të kundraligjshëm dhe pasojës së ardhur. Lidhja shkakësore vërteton lidhjen mes tre elementeve objektive dhe subjektive të faktit të paligjshëm; konkretisht sjelljes së paligjshme, fajit dhe pasojës së ardhur, pra dëmit të shkaktuar ne pasurinë, shëndetin ose personalitetin e subjektit të dëmtuar. Elementi i lidhjes shkakësore mbështetet ne parimin "*condicio sine qua non*", sipas të cilit nuk do të vërtetohej ardhja e pasojës së dëmshme nëse nuk do të kishte ndodhur shkak, sjellja e paligjshme dhe faji për shkaktimin e dëmit.

d) Demi, i cili duhet të jetë ekzistent dhe mund të ketë karakter pasuror ose jopasuror.

Ne vijim marrim ne analize ne mënyre të hollësishme secilin nga këta elemente për rastin konkret:

a) Dëmi në rastin konkret, siç dhe u trajtua më lart është evident, për shkak se si rezultat i ngjarjes, ka ardhur humbja e jetës së të nderit Prend Ceca familjar i paditësve (vëllai).

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Pukë janë kryer një sërë veprimesh hetimore dhe janë administruar një sërë provash shkresore si dhe akt ekspertimi mjeko ligjorë, ku ka rezultuar: Me aktin e ekspertimit mjeko-ligjor percaktohet se: " a. Ne trupin e viktimes Prend CECA gjatë kqyrjes së jashtme u konstatuan elektrohënja b. Elektrohënjat janë shkaktuar nga veprimi termik i rrymës elektrike. c. **Shkaku i vdekjes së shtetasit Prend CECA është ndalimi i menjëhershëm i punës së zëmrës si pasojë e kalimit në trup të rrymës elektrike asfiksimit (Hark elektrik)...**"

Dëmi i shkaktuar paditësve mund të kategorizohet si dëm jo pasuror dhe provohet nga të dhënat provave shkresore si aktit të ekspertimit mjeko-ligjor. Keto dëmtime dhe të tjera dëme janë analizuar dhe ne aktin e ekspertimit mjeko-ligjor raport vlerësimin psikologjik të psikologes si aktin e ekspertimit të ekspertit vlerësues të dëmeve shëndetësore. Nga tërësia e tyre rezulton që paditësja dhe ndërhyrësit kryesor kanë pësuar dem të natyrës jopasurore dëmtime të cilat vazhdojnë dhe sot.

Në konkluzionet e raportit vlerësues të psikologes për sa i përket paditësve thuhet shprehimisht: "*Konkluzione: Në bazë të përfundimeve të arritura, bazuar në të dhënat e mbledhura prej teknikave psiko-metrike të përdorura, bisedave, raportimeve, vetë-raportimeve dhe vëzhgimeve me Pjerin Ceca, Aleks Ceca, Perparim Ceca dhe Jani Ceca se: Te paditësit Pjerin Ceca, Aleks Ceca, Perparim Ceca dhe Jani Ceca vihen re aspekte të traumës që përsëriten duke shkaktuar vuajtje emocionale, shpirtërore të mendimeve, dhe të sjelljes. Shqetësimet e vazhdueshme të tyre, që ju kujton plotësisht ngjarjen si dhe pasojat e saj që nga momenti i ndodhjes e deri më sot. Ky konstatim shkakton reagime jo vetëm në nivel mendor por gjithashtu edhe në atë psikologjik duke sjell vuajtje në të gjitha drejtimet e jetës. Ngjarja e datës 24.02.2019 e në të cilën u aksidentua dhe humbi jetën Z.Prend Ceca ka ndikuar negativisht dhe seriozisht në personalitetin dhe ekzistencën e tyre. Pjerin Ceca, Aleks Ceca, Perparim Ceca dhe Jani Ceca dhe duke bërë që jeta e të ndryshoj thelbësisht në kuptimin përkeqësues të saj. Shkalla e lartë e prezencës së simptomave të humorit dhe të ankthit tek paditësit Pjerin Ceca, Aleks Ceca, Perparim Ceca dhe Jani Ceca ka cënuar funksionimin normal e të përditshëm të tyre, duke kompromentuar mundësinë e tyre për të realizuar potencialin njerëzor, duke ndikuar negativisht në harmoninë e tyre shpirtërore dhe për pasojë duke shkaktuar dëmtime të vazhdueshme dhe thelbësore të cilësisë së jetës...*"

b) Faji është një tjetër element për të lindur përgjegjësia jashtëkontraktore të organit të administratës publike. Në rastin konkret elementi faj i palëve të paditura, u evidentua nga një sërë provash.

-Prokuroria gjatë hetimeve ka thirrur dhe ka kryer akt ekspertimi teknik me një grup ekspertësh, për të përcaktuar shkakun e ndodhjes së ngjarjes aksidentale. Nga akti ekspertimit teknik ka rezultuar se: "...Shkaku determinant i ardhjes së pasojës me vdekje të ndjerit Prend CECA, janë mosveprimet në shkelje të Rregullores së shfrytëzimit Teknik, moszbatimi i kërkesave prioritare ligjore në sektorin e Energjisë Elektrike për sigurinë e jetës nga ana e subjektit OSHEE sh.a dhe konkretisht: 1- Viktima i ndjeri Prend CECA është marë në punë në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi dhe konkretisht me rregulloren e shfrytëzimit teknik 1-147; 2- Punëdhënësi (OSHEE sh.a) ka marë në punë viktimën e veprës penale pa ënë i paisur me dëshmi profesionale dhe me certifikatë aftësie mjekësore, duke shkelur kërkesat e V.K.M Nr 2007 dt. 09.05.2002 për punët e vështira dhe të rrezikshme. 3- Konstatohet mungesë në ngritjen e strukturave të posacme nga ana e OSHEE Njësia elektrike Pukë, të cilat janë të nevojshme për verifikimin e rreziqeve me të cilat punëmarrësit ndeshen gjatë punës. 4- Agjensia elektrike Pukë nuk ka kryer vlerësimin e rrishtit sipas rregullores së OSHEE si dhe në zbatim të udhëimit Nr 16 dt. 12.08.2016 për procedurat për kryerjen e vlerësimit të riskut për cdo vend pune në zbatim të ligjit Nr 10237, dt. 18.02.2010 "Për sigurinë në Punë" 5- Qendra e dispecerisë Shkodër ka marë rolin drejtues për grupet e punës, veprim që nuk është në kompetencën e tyre. Gjithashtu në aktin e ekspertimit janë identifikuar edhe shkeljet të kryera nga përgjegjësi i grupit të punës ku bënte pjesë edhe viktima, pasi kryerja e riparimeve të defekteve teknike bëhet sipas një plani të parapërcaktuar. Subjekti përgjegjës shtetasi Vladimir VILA duhet të ngrinte grup pune nga jo më pak se 2 (dy) persona të cilët duhet të pajisen me masat teknike dhe organizative që garantojnë mbrojtjen e personelit nga cdo rrezik gjatë punës. Këto rregulla të natyrës teknike janë detyrim që rrjedhin nga rregullorja e sigurimit teknik paragrafi 2-18. Trasmisioni ndarësit nuk është ndërtuar sipas rregullave inxhinierike. Në vecanti ajo që ka cënuar kërkesën e Rregullores Sigurimit Teknik, është fakti se transmisionet e komandimit të ndërtesave elektrike të tensionit të lartë duhet të jenë të bllokuara me celës apo mekanikisht, me qëllim që ai të mos manovrohet nga persona të paautorizuar për manovrimin e tij. Në bazë të aktit të ekspertimit një tjetër element është se rjeti ku po punonte i ndjeri nuk ka qënë një rjet elektrik i sigurt, pasi kemi pasur kryqëzim linjash të TM dhe TL. ...".

është se rjeti ku po punonte i ndjeri nuk ka qënë një rjet elektrik i sigurt , pasi kemi pasur kryqëzim linjash të TM dhe TL. ...”.

Prokuroria në përfundim të hetime dhe pas administrimit të akteve teknike i është drejtuar gjykatës me: “Prokuroria e Rrethit Pukë në përfundim të hetime dhe pas administrimit të aktit teknik i është drejtuar Gjykatës së rrethit Pukë me: “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal Nr 22/2019” për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë” si pasojë e vdekjes së të ndjerit Prend Ceca duke marrë të pandehur Vladimir Vila (punonjës i OSHEE) dhe personin juridik OSHEE i paditur në këtë gjykim .

Sipas aktit të ekspertimit Elektrik-Mekanik të shoqëruar me fotografi rezulton se: “...Pergjigje Nr.1. Mbeshtetur ne dokumentat shkresor te dosjes gjyqesore, aksidenti ka ndodhur ne fiderin e tensionit te mesem 10kv “Ikballe Ferze” , pikerisht ne lagjen “Ndermillja” te fshatit Fierze , Njesia Administrative Fierze, Bashkia Fushe-Arrez. Shtetasi Prend CECA, ne momentin e aksidentit ka qene duke punuar ne nje shtylle prej druri, per eleminimin e difektit te ketij fideri, i cili furnizohet me energji nga N/Stacioni 110/10kv Gropaj, Drejtoria Rajonale e OSHEE-se Shkoder. Mbeshtetur ne dokumentat shkresor te dosjes gjyqesore konstatohet se ditën e aksidentit ne kete rajon ka qene kohe e keqe, me ere ate fuqishme. Fideri “Ikballe” , ka kryqezim me fiderin e “Gege Hysenit” , pikerisht ne kampaten qe dilte nga shtylla(prej druri) , ne te cilen ishte duke punonuar i ndjeri per eleminimin e difektit (lidhje e shkurter) .Gjate veprimeve te tij ne pune e siper, viktima ka ren nen tension , si pasoje e se ciles ka gjetur vdekjen e menjehereshme .I ndjeri pasi eshte siguruar per mungesen e tensionit ne fiedern e “Ikballes” pra ishte i çkyçur ne nestacionin “Gropaj” eshte ngjitur ne shtylle per te eleminuar difektin. Mbeshtetur ne te dhenat shkresore te dosjes gjyqesore del qarte se fideri tjetër i “Gege Hysenit” , i cili kryqezohet me fiderin e “Ikballes”(pikerisht ne kete kampaten pas shtylles prej druri ku punonte ndjeri) , ishte ne pune, pra ishte nen tensionin TM 10kv . Mbeshtetur ne “Tabelen fotografike” si dhe ne pershkrimet te konfiguracionit te vendit te ngjarjes prej tre eksperteve : Ing. Vangjel SHKURTI Ing. Cene LILA Ing. Ilir SHTJEFANAKU, del qarte se shtylla prej hekuri e fiderit te “Gege Hysenit” , nga del kampata e cila kryqezohet me fiderin e “Ikballes” ka qene e demtuar e e thyer duke u pjerësuar ne nje mase te tille sa ka sjelle si pasoje ,qe largesia e percjellesave te ketyre fiderave ne kryqezim te ishte shume me vogel se normat e lejuara teknike . Si pasoje e kohes se keqe me erera te fuqishme, si pasoje e lekundjes se percjellesave , ne nje moment percjellesat e linjes se “Gege Hysenit” kane prekur percjellesat e linjes se “Ikballes” , kjo ka ber qe i ndjeri Prend CECA, i cili ishte duke punuar, ka ren nen tensionin e mesem 10 kv. Ky kontakt me tensionin , ka shkaktuar qe neper trupin e te ndjerit te kaloj rryma elektrike neper rrugen , duar – krahe – trup- kembe- shtylle- toke . Si pasoje e kalimit te kesaj rryme , ka ndodhur vdekja e menjehereshme e te ndjerit. Viktima eshte konstatuar i vdekur mbas nje kohe te gjate , pasi ai kishte rene nen tension, si rrjedhoje nuk i ka qene e mundur qe ti jepet ndihma e pare. Demtimet qe ka pesuar si rezultat i kalimit te rrymes elektrike neper trupin e viktimes , si edhe shkakun e vdekjes se tij nga rryma elektrike , e ka pershkruar me hollesi edhe Eksperti Mjekoligjor Dr.Avni BOSHNJAKU ne “AKT DESHMI MJEKO-LIGJORE NR.13” date 25.02.2019. (akt i dëshmisë mjeko ligjore). Pergjigje Nr.2 Mbeshtetur ne dokumentet shkresore te dosjes gjyqesore , duke bere nje analizë të kujdeseshme nga ana e eksperteve konkludohet se shkakun i ardhjes se tensionit ne vendin(shtyllen) ku kryente riparimin e difektit i ndjeri Prend CECA , ka ardhur si shkak i difektit te fiderit te “Gege Hysenit” . Ky fider kryqezohet me fiderin e “Ikballes” pikerisht ne kampaten pas shtylles prej druri ku punonte ndjeri, kujtojmë se ky fider ishte nen tensionin TM 10kv . Siç edhe pershruhet ne dokumentat shkresore te dosjes gjyqesore , shtylla ankerore kendore prej çeliku e pozicionuar perpara shtylles nga del kampata e fiderit te “Gegehysenit”, e cila kryqezohet me fiderin “Iballe”, ka qene e perthyer ne pjesen e siperme te saj(shih fotografimin e shtylles ne tabelen e fotografive Fig.nr.1 dhe nr.2). Kjo shtylle “ankerore” prej celiku eshte vendosur ne kendin ku linja per shkak te terenit merr kthese . Pikerisht arsyeja e vendosjes se shtyllave “ankerore” ne kendet(kthesat) e linjave te behet sepse pikerisht ne kendin e linjave forcat qe ishtrohen nga pasha e linjes, jane shume te medha, dhe nuk mund te perballohet nga nje shtylle (BA) e thjeshte ndermjetese. Se pari : - Thyerja e kesaj shtylle ne majen e saj , ka sjell pjerresimin e percjellesave nga aksi vertikal i linjes, i kampatave pas shtylles ankerore te thyer. Duhet theksuar se , konforme rregullave KTZ ne fuqi(KTZ 33-81) , shmangia e lejuar ne lartesisht e shtyllave ne pikat e kryqezimit , nuk mund te kaloje vleren l/150, qe ne rastin e kesaj kampate, sic eshte perlllogaritur prej grupit te eksperteve(Ing. Vangjel SHKURTI , Ing. Cene LILA , Ing. Ilir Shtjefanaku) shmangia ne lartesi nuk duhet te kaloj vleren prej 6.6cm , ndersa ne rastin e shtylles ne fjale kjo shmangie eshume here me e madhe. Se dyti : - Gjithashtu ky difekt(perthyerja e shtylles ankerore), ka sjell pasojen tjetër qe per shkak te forcave terheqese te linjes ne te dyja pjeset e saj te kendit te ktheses, shtyllat ndermjetese qe jane ne rradhe pas shtylles “ankerore”, te persojne pjerresim te theksuar ne anan e brendeshme te kendit , gje qe ka favorizuar akoma edhe me shume daljen e kesaj linje(fideri“Gehysen”) nga aksi vertikal i saj. Kjo dallohet qartesisht edhe nga fotografite e bera ne vendngjarje nga grupi i eksperteve te mesiperme ne kohen e ndodhjes se aksidentit(shih foton ne Fig. Nr. 1 dhe Fig Nr2 ne tabelen fotografike). Se treti: Nga ana e grupit te eksperteve(Ing. Vangjel SHKURTI , Ing. Cene LILA , Ing. Ilir Shtjefanaku), eshte konstatuar se pjerresimi i shtyllave ne kampaten e kryqezimit te ketij fideri eshte shkaktuar edhe si rrjedhoje e montimit jo korrekt te shtylles se pare(pas shtylles ankerore) te kesaj kampate, ne fotografine e ber prej eksperteve konstatohet se, gropa e shtylles eshte lene e pambushur plotesisht, kjo ka bere qe rezistenca mekanike ndaj pjerresimit te shtylles te zvogelohet edhe me shume duke lejuar pjerresimin e shtylles. Se katerti : Nga ana e grupit te eksperteve(Ing. Vangjel SHKURTI , Ing. Cene LILA , Ing. Ilir Shtjefanaku), gjithashtu eshte konstatuar se tranversat ne te dyja shtyllat e kampates se kryqezimit , jane realizuar me nga nje izolator, do te duhej qe ne konformitet me R.S.T. , keto tranversa te ishin me dopjo izolator , kjo ka shkatuar qe per shkak te peshes se percjellesave te linjes, ne keto shtylla te ndodhi pjerresimi i kunjave mbajtes se izolatoreve , gje qe ka ndikuar edhe kjo ne pjerresimin e metejsheem te aksit te linjes. Kjo dalje nga aksi vertikal i linjes(fiderit “Geghysen”) shkakton zvogelimin e lartesisht se percjellesave te kesaj linje nga toka. Meqenese linja e “Geghysenit” kalon mbi linjen e “Iballes” , kjo humbje e lartesisht se percjellesave te linjes se “Geghysenit” , sjell njekohesisht edhe zvogelimin e largesisht midis tyre dhe percjellesave te linjes se “Iballes”. Gjithashtu nga ana e grupit te eksperteve eshte konstatuar se tranversat ne te dyja shtyllat e kampates se kryqezimit te fiderit te “Ikballes”, jane realizuar me nga nje izolator, ndersa duhet qe ne konformitet me R.S.T. , keto tranversa te ishin me dopjo izolator, kjo ka shkatuar qe per shkak te peshes se percjellesave te linjes, ne keto shtylla te ndodhi pjerresimi i kunjave mbajttese te izolatoreve , gje qe ka ndikuar edhe kjo ne pjerresimin e metejsheem te aksit te linjes. Nga sa pershkruam me siper, mund te konkludojmë se, pikerisht ky pjerresim nga aksi i , ka sjell qe percjellesat ne te dyja linjat te mos jene te tiruar aq sa duhet , kjo ben qe percjellesat te jene te lirshem duke krijuar nje “varje” te palejuar teknikisht. Kjo gjendje e percjellesave ne ted y linjat , krijon kushtet te favoreshme qe ererat ti lekundin ata lehtesisht . Ne nje kryqezim linjash, kjo lekundje nga ererat , sidomos per rastin kur largesia midis percjellesave ted y

linjave qe kryqezohen eshte zvogeluar, sigurisht qe shkakton bashkimin e percjellesave. Ky kontakt midis percjellesave te te dy linjave, shkakton difekte ne fidera si lidhje te shkurtera te perkoheshme midis fazave, te cilat shoqerohen me hark te fuqishem elektrik . Ky fenomen ka ndodhur edhe ne kryqezimin midis dy fiderave "Iballe" dhe "Geghysen" , ne vendin ku ndodhi aksidenti me pasoje vdekjen e te ndjerit Prend CECA. Sic duket edhe nga shenimet ne "Librin Operativ" te N/st Gropaj , gjate kesaj periudhe kohe ne nenstacion , kane ndodhur disa çkyçje te fiderit te "Ikballes", pra per shkak te res se forte qe ka fryr ne kete zone fenomeni qe spjeguem me siper, ka shkaktuar edhe stakimet e herepashereshme te fiderit te "Iballes". Bazuar ne dokumentet shkresore , fideri I "Ikballes" , ne oren 13.08 te dates 24.02.2019 , eshte çkycur nga nje lidhje e shkurter , dhe nuk eshte ven dot perseri ne pune sepse e ne proven e rikyçjes ai eshte çkyçur perseri nga mbrojtja e castit . I pershkruam me kujdes fenomenet e mesiperme , per te ber sa me te thjeshte ne te kuptuar , se cfar mund te kete ndodhur ne kamapten e kryqezimit te dy fiderave(fid. i "Ikballes" dhe fid. i "Gegehysit") , gjate kohes kur viktima z. Prend CECA ishe duke punuar ne shtylle. Gjendja teknike e te dy fiderave(fid. i "Ikballes" dhe fid. i "Gegehysit") ne vendin ku ndodhi aksidenti, eshte jashte kushteve teknike, ne shkelje te standardeve teknike te projektimit KTP , te cilat jepen qartesisht ne KTP e series se vitit 1978 "Linjat Ajrore te Tensionit te Larte" si dhe KTP e seris 18-78 , Kapitulli XIV , "Nderprerja dhe Afrimi i Linjave ndermjet Tyre" . Gjendja jashte kushteve teknike, e mesiperme, kushtezoi krijimin e rethanave , te cilat shkaktuan aksidentin me pasoje vdekjen e te ndjerit Prend CECA. Largesia e vogel midis percjellesave te dy linjave ne kryqezim(sic eshte sqaruar me siper), si edhe per shkak te kushteve te renda atmosferike, ata(percjellesat), jane lekundur nen veprimin e forces se eres, e cila ate dite ka qene e fuqishme. Kjo lekundje ka ber qe percjellesat e fiderit te "Geghysenit" te cilet ishin nen tension te prekin me percjellesat e fiderit te "Ikballes" ne pjesen ku kampatat kryqezohen. I ndjeri ne kohen e kasidentit ka qene duke punuar shtyllen e fiderit "Iballe". Fatkeqesisht ne ato momente , ai ka patur neper duar percjellesat e kesaj kampate ne tentative per te eliminuar difektin, pikerisht ne kete kohe ka ndodhur kontakti midis percjellesave te fiderit te "Geghysenit" , i cili ishte nen tension , me percjellesat e linjes e "Ikballes". Kjo ka shkaktuar kalimin e rrymes elektrike ne trupin e tij , duke i shkaktuar vdekjen e menjehereshme . Ne perfundim per tju pergjigjur pyetjes se pales paditese , "...se cili ka qene shkak i ardhjes se tensionit ne vendin(shtyllen) ku kryente riparimin i ndjeri Prend CECA ?.." konkludojme : Shkak i ardhjes se tensionit ne vendin(shtyllen) ku kryente riparimin i ndjeri Prend CECA, kane qene kushtet teknike ne shkelje te normave dhe standardeve(KTP dhe KTZ te pershkruara me siper) ne fuqi, gjithashtu edhe ne shkelje te "Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike" , "KAPITULLI VI" i saj , pika 6.1 , ku pershkruhet se : "...". Pergjigje Nr.3..., mund te konkludojme se , bazuar ne dokumentet shkresore te dosjes gjyqesore, i vetmi veprim i pershkruar ne menyre te dokumentuar , si ne librin e shenimeve te veprimeve operacionale ne N/stacionin 110/35kv Gropa-Fierze , eshte çkyçja e fiderit "Iballaj" ne kete N/stacion ne oren 13.30 te dates 24.02.2019 , si dhe vendosja e pllakates "MOS KYÇ", mund te konkludojme : 1.- Mungesa e spcialitetit perkates(si electricist) nga ana e punemarresit z. Prend CECA . Me duhet te theksoj qe ne fillim te pergjigjes time se shkelja e pare dhe me e renda teknike ne kete aksident me pasoje vdekjen e te ndjerit Prend CECA , eshte : - Rekrutimi ne pune e ketij punonjesi ne shkelje te "Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike" , pikerisht neni 1-147 , dhe 1-148 i kesaj rregulloreje. (neni rregullores). Bazuar ne dokumentet shkresore te dosjes gjyqesore i ndjeri Prend CECA , ka filluar lidhur kontrate pune me OSHEE , me daten 01.02.2016 , ne pozicionin Elktriciist ne "Mirmbajtje TM/TU" prane Drejtorise Rajonale Shkoder/Agjensia Puke / Sektori Teknik Mirembajtje. Kjo eshte nje shkelje flagrante e "Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike", pika 1-47 dhe 1-148 te saj , ne te cilen kërkohet: Se pari , qe ne momentin e rekrutimit ku shtetas te zoteronte "kategorine perkatese te grupit te punes" si electricist . Se dyti , qe ne momentin e rekrutimit ku shtetas te zoteronte grupin duhur te sigurimit teknik . Ne mbeshtetje te pikes 1-148 te RR.S.T.E. edhe nese I plotesonte keto pika te nenit 1-147 , punonjesi do duhej ti nenshtrohej nje provimi , ku te kontrollohen niveli i tij mbi njohjen e rregullores se sigurimit teknik ne masen qe i takon vendit te punes. Ky provim do te behej ne prani ten je komisioni te perber te pakten nga dy persona, njeri kryeinxhinieri i ndermarjes, ose kryeenergjetiku , si dhe nga pergjegjesi i reparit . Shtetasi Prend CECA , rzulton se ka kryer shkollen e mesme te pergjithesme, pra nuk ka arsim profesional , duket se nuk plotesohet pika a .Theksojme se ne dokumentet shkresore te dosjes gjyqesore nuk ekziston asnje shkrese , qe te vertetoje nese shtetasi , disponon ndonje "Çertifikate" per kategorine e grupit te punes si electricist duket se nuk plotesohet pika b .Ne dokumentet shkresore te dosjes gjyqesore nuk ka asnje shkrese ku te vertetoje se punonjesi Prend CECA, ka bere provimin , mbi njohurite ne lidhje me R.S.T.E. duket se nuk plotesohet pika c . Pra duket qarte se rekrutimi i shtetasit Prend CECA , ne pune sipunonjes I OSHEE-se , eshte kryer ne kundershkrim flagrand me "Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike", pika 1-47 dhe 1-148 te saj . Me poshte po rendisim nje sere praktikash qe ndjekin punonjesit e OSHEE-se dhe qe bien desh me "Rregulloren e Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike" . 2.- Gjate pocesit per eliminimin e avarive dhe difekteve ne rrjetat e tennsioneve te larta , keto praktika konsistojne ne nje sistem "Rregullash te aplikuar" nga ana e OSHEE-se , praktike kjo qe nuk eshte e shkruar ne asnje dokument shkresor , por qe deklarohet nga punonjesit dhe pergjegjesit e saj, ne "Procesverbalet te personave qe kane dijeni per ngjarjen". Duke analizuar dokumentet shkresore te dosjes, pikerisht deklarimet e personave qe kane dijeni per ngjarjen , kryesisht punonjesit(specialiste electricista), si edhe specialistet drejtues qe kane dhene keto deklarime, gjithashtu edhe dy "Aktet e Ekspertimit Teknike" te realizuara per kete aksident dhe qe jane pjese e dosjes, konkludojme se ne deklarimet e mesiperme te specialisteve, ne cdo rast, konstatohet se menyra e komunikimit midis tyre , pra "rregullat e aplikuar" nga ana e subjektit OSHEE , per eliminimin e avarive dhe difekteve ne rrjetat e tennsioneve te larta , bien desh me keto pika te "Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike" . Veprimet operative . Menyra e komunikimit sipas ketyre "Rregullave te aplikuar" nga ana e OSHEE-se , shmangin komunikimin e drejteperdrejte midis personelit te N/stacione me personelin pergjegjes te punimeve. Sipas kesaj praktike te "Regullave te aplikuar", per te opruar ne fiderin "Iballe" , personi pergjegjesper kete fider (Z.Vladimir Vila) nuk ka te drejte te kerkoj apo te bej manovrimet e nevojeshme duke komunikuar drejteperdrejte me operatorin e nenstacionit . Per cdo rast te veprimeve operative per ndryshimin e skemes, ai detyrohet nga keto "Regulla te aplikuar"qe te komunikojte me dispecerin Rajonal ne Shkoder . Kjo eshte ne kundershkrim piken 2-13.b , te "Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike" (....) . 3.- Menyra e hapjes dhe mbylljes se fletes se punes. Ne "Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik

te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike” pika 3-41 te, pershkruan se , perpara hapjes se fletes se punes , personi pergjegjes i ndermarjes(kryeinxhinieri ose nje tjeter person i ngarkuar kete detyre) , i jep urdher drejtuesit dhe lejuarit per nxjerrjen e pajisjes nga puna (lexo poshte). Ne zbatim te ketij neni do te duhej qe operatorit e N/stacioneve(te cilet jane “Lejuarit e punimeve”), para se te hapej fleta e punes , do te kryejne nje veprim operativ, ne bashkerendim te drejteperdrejte me Drejtuesin e punimeve(qe ne rastin tone eshte z.Vladimir Vila). Ne shkelje me kete pike te ”Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike”, ne zbatim te praktikës “Regullat e aplikuar” te OSHEE-se, perghjegjesi i punimeve (z.Vladimir Vila) kerkon prej dispecerit rajonal leje per punimet qe do te kryej, pas kesaj, Dispeceri rajonal urdheron Operatorin e N/stacionit , qe te filloj procedurat per zbatimin e “Masave teknike” dhe te “Masave Organizative” per kryerjen e punimeve. Duket qarte se menyra e komunikimit te punonjesve sipas praktikës “Regullat e aplikuar” eshte ne shkelje te ketij neni te rregullores se sigurimit teknik. Gjithashtu konstatohet se praktika qe OSHEE zbaton me “Regullat e aplikuar” eshte ne shkelje edhe te, pikes 4-3 te ”Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike” . Ne kete pike duket qarte se elektrikisti qe kontrollon linjen, ne momentin qe konstaton se ne toke ka ren nje percjelles, pasi ben veprimet e nevojeshme conform kesaj pike , menjeher njofton personelin operativ te nenstacionit , nga furnizohet me energji ky fider (lexo me poshte). Duket qarte se menyra e komunikimit te punonjesve sipas praktikës “Regullat e aplikuar” eshte ne shkelje te ketij neni te rregullores se sigurimit teknik sepse kjo praktik ndalon komunikimin e drejteperdrejte te tij me operatorit e nenstacionit. 4.- Mungesa e rregulloreve te brendeshme te shkruara dhe firmosura(vulosura) nga personeli inxhiniero teknik i ndermarjes. Bazuar ne dokumentat shkresore te dosjes gjyqesore , konstatohet se nga ana e Instancave pergjegjese inxhiniero-teknike dhe administrative te OSHEE-se , nuk eshte perpiluar asnje RRegullore e brendeshme e shfrytezimit te Pajisjeve m, dje instalime elektrike . Mbeshtetur ne “Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike”. “KAPITULLI VI” , PIKA 6.2 e saj , ngarkon cdo subjekt , prodhues, transmetues dhe perdorues te energjise elektrike , qe ne zbatim te RR.S.T.E., te perpiloj Rregulloren e brendeshme .(shiko rregulloren). Kjo rregullore e brendeshme e ndermarjes , rregullon ne menyre te hollesishme mardheniet , detyrat dhe te drejtat e gjithe punonjesve elektriciste te ndermarjes. Ajo ne fakt eshte zbatim , per kushtet specifike te ndermarjes i “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike”. Nuk ka asnje rregullore te brendeshme te pergatitur prej personelit inxhiniero teknik , ku te tregohen qartesisht mardheniet midis personalit me njeri tjetrin, si edhe rregulla te vecanta pe pershtatje me kushtet specifike te ndermarrjes. Theksojme se edhe nese per nje cast i lemë menjane, shkeljet ndaj R.S.T.E.(te siperpermendura) ne praktiken e “Rregullave te aplikuar” te OSHEE-se , atehere nga dokumentet shkresore te dosjes gjyqesore, ne deklarimet e vet punonjesve, konstatohet se edhe keto “Rregulla te aplikuar” nuk njihem dhe as nuk zbatohen ashtu sic pershkruhen ne deklaratat e tyre(ne fakt theksojme se ka vetem pershkrime verbale te kesaj praktike). 5.-Komunikimi me sms. Ne deklarimet midis dispecerit rajonal Shkoder , praktikohet edhe komunikimi nepermjet sms me telefon. Nuk ka asnje pik te “Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike” dhe ne asnje ligj tjetër, te konformitetit te pajisjeve dhe instalimeve elektrike, ku te njihet komunikimi midis operateve te ndryshem ne nje system elektrik, me anen e mesazheve telefonike (sms). 6.- Referuar materialeve shkresore të dosjes gjyqesore, konstatohet se per punimet qe jane kryer ne Fiderin e “Ikballes”, mungojne “Fletet e Punes”. Ne “Aktin Ekspertimin Teknik” e perpiluar nga ISHTI , prejdy eksperteinxhinierave , Ing.Aleksander PACI dhe Ing . Naim VATA , konstatohet pikerisht ky konkluzion se punimet ne fiderin e ‘Ikballes’ perhere jane kryer pa “Flete Pune” . Ne konkluzion eshte arritur mbeshtetur ne faktin se megjithese nga ana e tyre eshte kerkuar qe tu vihet ne dispozicion , “..qofte edhe vetem nje Flete Pune” , nga tremujori i fundit per punimet e kryera ne kete fider, nga ana e OSHEE-se nk i eshte vene ne dispozicion asnje flete pune. (shiko kërkesë). Mbeshtetur ne “Rregulloren e Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike”, “Fleta e punes” eshte nje document qe perpilohet ne dy kopjo , nje kopjo e mban personeli i punes qe lejon punimet(“lejuarit i punimeve”), ndersa kopjoja tjetër i dorezohet “Mbikqyresit te punimeve” . (shiko rregulloren). Mungesa e fleteve te punes, ne kete tremujor tregon qartasi se , te pakten kete periudhe kohore , gjithe punimet e kryera ne Fiderin “Iballe” jane kryer prej te ndjerit Prend CECA , jane kryer vetem prej tij(ndoshta i ndihmuar prej vellait te tij Besmir CECA ,(sic deklaroi ky person perpara oficerit te Policise Gjyqesore” , dhe keto punime jane kryer pa flete pune per arsye se , i ndjeri Prend CECA nuk ka patur grupin e IV te sigurimit teknik , ai ka patur grupin III e trete te sigurimit teknik, dhe nuk i lejohet te hapi flete pune. Kryerja e punimeve me “Flete Pune” , eshte masa e pare e detyrueshme ne zbatim te , “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , “KAPITULLIN III” , “MASAT TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE ME HEQJE TE PLOTE OSE TE PJESESHME TE TENSIONIT NGA IMPIANTET ELEKTRIKE”, B. Masat Organizative, pika 3-27.a, ku përshkruhet : (shiko rregulloren). Duket qarte nga sa me siper , mungesa e “Fletes se Punes” , eshte ne shkelje te, Pikes B. Masat Organizative të R.S.T. , Pika 3-27.a. Kryerja e punimeve , pa marre masat e nevojeshme te mbrojtjes nga rreziku i rrymes elektrike eshte ne fakt shkelje flagrante e “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike”, “KAPITULLIN III” , “MASAT TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE ME HEQJE TE PLOTE OSE TE PJESESHME TE TENSIONIT NGA IMPIANTET ELEKTRIKE” , A. Masat Teknike , pika 3-1.c.d.e , ku përshkruhet : (shiko rregulloren). Si psoje nuk jane zbatuar edhe pikat 3 – 30 dhe 3 – 31 te “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” ,e cila ben fjale per per dtyrat e “Drejtuesit Teknik”, “Lejuarit Teknik” dhe “Udhezuesit Teknik” . (shiko rregulloren). Referuar materialeve shkresore të dosjes gjyqesore konstatohet shkelje e “Ligjit Nr.8734, datë 1.2.2001 “PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE TË INSTALIMEVE ELEKTRIKE” nenet 6 pika 5.a dhe neni 7 pikat 1 e 2 . (shiko ligjin). Konstatohet qe jane shkelur “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , ne pikat 1 – 77 dhe 1 – 2 . (shiko rregulloren). Konstatohet qe jane shkelur “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , ne pikat 4 - 1 dhe 4 – 2 , 4 – 3 dhe 4 – 5. (shiko rregulloren). Theksojme se “Rregullorja e Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , ne pikat 1 – 24 , kerkon qe per çdo fatkeqsitate rende (me vdekje) nga goditja e rrymes elektrike duhet bere analiza teknike , per te analizuar shkeljet e R.S.T.E. dhe te ligjeve te konformitetit te pajisjeve elektrike , per te konstatuar personat pergjegjes per shkeljet, duke percaktuar edhe masat e denimit perkatesisht me shkallen e shkejtëve teknike te bera. (shiko rregulloren). Referuar materialeve shkresore të dosjes gjyqesore , nuk ka snje document shkresor ku te tregohet nesenese nga ana e OSHEE-se eshte ber nje analize e tille . Duhet te

sjellim ne kujtese se ne analizen e bere ne Drejtorine e Inspektriatit Qendror Teknik Elektrik Industrial nga ana inspektoret e sigurimit teknik te ISHTI-it , jane mbajtur qendrime , me masa , ku kane mare denime me gjoba , per shkelje te Rr.S.T. E , konforme Ligjit Nr.8734, datë 1.2.2001 , te gjithë punonjesit qe kishin lidhje me aksidentin me pasoje vdekjen e te ndjerit Z. Prend CECA .Referuar materialeve shkresore të dosjes gjyqesore, pikerisht deklarimet e personave qe kane dijeni per ngjarjen si edhe “Procesverbalit te kqyrjes se vendit te ngjarjes” konstatohet se per punimet qe jane kryer ne Fiderin e “Ikballes”, nuk jane marre masat teknike per mrojten nga rreziku i rrymes elektrike . “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 6.1; “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 1-147. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 1-148. ”Rregullores se Sigurimit dhe shfrytezimit Teknik te Pajisjeve , Impianteve dhe instalimeve Elektrike” pika 2-13.b . “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 3 – 41. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 4-3. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 6.2. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 1-144. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 1-146. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 3-42. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 3-51. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 3-27.a. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 3-1. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 3-30.a.b.c. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 3-31.. “Ligjit Nr.8734, datë 1.2.2001 “PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE TË INSTALIMEVE ELEKTRIKE” nenet 6 pika 2 dhe pika 5.a dhe neni 7 pikat 1 e 2 . “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 1-77 “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 1-2. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 4-1. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 4-2. “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht pika 4-3. Pergjigje Nr.4. Ne pergjigje te kesaj pyetje , duhet te theksojme se ne teresine e shkeljeve qe jane renditur gjate pershkrimit te pergjigjes per pyetjen Nr.3 , ekspertet konsiderojne si shkelje determinante ne shkaktimin e aksidentit me pasoje vdekjen e te ndjerit Prend CECA shkeljet : Shkelja e “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” , pikerisht neni 1-147 , dhe 1-148 i kesaj rregulloreje. Shkelja e “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike”. “KAPITULLI VI” , PIKA 6.2 e saj , ngarkon cdo subjekt , prodhues, transmetues dhe perdorues te energjise elektrike , qe ne zbatim te RR.S.T.E., te perpiloj Rregulloren e brendeshme . Duhet te theksojme se gjithë shkeljet e tjera (konstatuar 21 shkelje teknike) te konstatuara gjate pershkrimit te ketij akti teknik , jane rrjedhoje pikerishte e shkeljeve te dy neneve te mesiperme . Ne perfundim per te permbyllur argumentet tona ne lidhje me pyetjen Nr.4 , duhet te theksojme se , siç edhe i kemi argumntuar me hollesi te treja keto pika te “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike”(pikat 1-147, 1-148 dhe 6.2) , i vetmi subjekt , i cili mban pergjegjesi , ne lidhje me zbatimin tyre eshte OSHEE. Bazuar ne nenet 1-10 dh1 1-153 te “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet Instalimet dhe Pajisjet Elektrike” te cilat pershkruajne se, pergjegjes per zbatimin e “Rregullores se Sigurimit dhe Shfrytezimi Teknik per instalimet , Pajisjet dhe Impiantet Elektrike” , bazuar ne pikat 1 – 10 dhe 1 – 153, jane pikerisht, Drejtori , kryeinxhinierin , kryeenergjetiku , apo personat te tjere qe kryejne funksionin e tyre. (shiko rreguloloren). Nga shqyrtimi i pyetjeve te Pales se Paditur si dhe te Avoka tyres se shtetit , konstatojme se pergjigjet ne lidhje me keto pyetje jane ezauruar me siper , gjate perpilimit te Aktit te ekspertimit Elektrik nga ana jone , ne pershkrimet e pergjigjeve te Pales se paditur .E pa ezauruar mbetet vetem pika (c) e pyetjes Nr. 1. Nese eshte e mundur ky pershkrim te shoqerohet me nje skice grafike..(shiko pamjen grafike...” .

Pra, elementi faj rezulton i provuar si më lart u parashtrua përmes akteve të ekspertimit te realizuar nga prokuroria dhe nga akti I ekspertimit elektrik, të cilët kanë arritur në konkluzionin se shkelja e ligjit dhe akteve nënligjore ka ardhur përmes veprimeve dhe mos veprimeve me dashje apo me pakujdesi, çka provon elementin faj të paleve të paditura si punëdhënës dhe jo të punëmarrësit të ndjerit Prend Ceca. Përsa i përket prapsimit të paditurit se ka qënë ditë e djelë dhe jo ditë punë kjo është e vërtetë, por nga hetimi i prokurorisë rezulton se i ndjeri Prend Ceca për shkak të llojit dhe pozicionit të punës si elektrikist (defekteve apo emergjencave) është thirrur në punë me sms në ditë pushimi nga eprori i tij dhe nuk ka shkuar në një punë private, por në përmbushje të detyrave dhe kontratës së punës. I padituri ka shkelur K.Punës si dhe legjisllacionin e posaçëm të sigurisë në punë, pasi nuk ka marrë masa për sigurimit e të punësuarit të tij.

c) Paligjshmëria e veprimit apo e mosveprimit është kriteri tjetër. Provohet plotësisht që veprimet e mosveprimet e palës së paditur në rastin konkret te (OSHEE), (OSSH), (FTL); (FSHU), karakterizohen nga kundërligjshmëria e tyre rrjedhojë e të cilave është edhe ardhja e dëmit. Edhe në padinë për shpërblimin e dëmit, zbatohet parimi i sanksionuar në nenin 12 të K.Pr.Civile, sipas të cilit pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj. Barra e provës në rastin e padisë për shpërblimin e dëmit ka një specifikë që nuk ndeshet në paditë e tjera. Me konkretisht barra e provës për të vërtetuar se ka dëm dhe cilët janë kufijtë e tij faktikë, real dhe ekonomik- pasuror i takon paditësit, i cili është në të njëjtën kohë edhe pala që ka pësuar dëmin. Për çdo element tjetër të gjykimit civil që ka si objekt shpërblimin e dëmit barra e provës kalon tek i padituri për shkak të natyrës së veprimitarisë që ka kryer si subjekt tregtar monopol në shpërndarjen e energjisë elektrike ne Shqipëri. Referuar rastit në gjykim, ashtu siç u citua më sipër, kur u fol në lidhje me legjitimitimin pasiv të palëve të paditura, nga gjykata u arrit në përfundimin se, ngjarja e ndodhur në datën 24.02.2019 në lagjen “Ndërmillas” fshati Fierzë, njësia Administrative Fierzë Bashkia Fushë Arrëz, ku ka ndërruar jetë i ndjeri Prend Ceca, ka ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të paligjshme të palëve të paditura. Këto veprime kanë sjellë dëmtim të interesave të ligjshme të paditësit dhe që u provua nga tërësia e provave shkresore dhe konkluzionet e akteve te ekspertimit te realizuara gjate gjykimit.

d) Për sa i përket lidhjes shkakësore kusht tjetër ky, në kuptim te nenit 609 te K.Civil, për pranimin e pergjegjesise civile jashtekontraktore, ajo nënkupton lidhjen ndërmjet sjelljes (veprimit a mosveprimit) së paligjshme e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Ne këtë kuptim, lidhja shkakësore nuk ndërpritet nëse pas vërtetimit të faktit të paligjshëm dhe pasojës “natyrale”, “materiale”, te ardhur prej tij, pra dëmtimit (cenimit) te interesave te ligjshme te subjektit pasiv nga sjellja e shkaktuesit te demit, vijojnë e vërtetohen fakte te reja me pasoja te dëmshme, te cilat konsiderohen te lidhura e rrjedhoje direkte dhe e menjëhershme e te njëjtit fakt te paligjshëm, përderisa provohet qe nëse ky nuk ndodhte, fakti i ri, i mëvonshëm, ne vetvete, nuk mund te shkaktonte edhe ai te njëjtën pasoje te dëmshme. Edhe në lidhje me

këtë element të përgjegjesisë për shkaktimin e dëmit, referuar rastit në gjykim, ai ekziston, pasi sipas të dhenave të kartelës klinike, akt ekspertimit mjeko-ligjorë të kryer përgjatë procedimit penal dhe këtij gjykimi, dëmtimi i të ndjerit Prend Ceca ka ardhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të kundraligjshme dhe me faj nga palët e paditura ku ishte punësuar i ndjeri, dhe jo për faj të këtij të fundit.

Së katërti, për sa i përket natyrës së dëmit të pretenduar dhe masës së tij Gjykata arsyeton:

- **Në lidhje me demin jopasuror :**

Në lidhje me shpërblimin për demin jo pasuror, Gjykata ka parasysh konkluzionet e vendimit unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka bërë kategorizimin e figurave të dëmit në atë pasuror të parashikuar në nenin 640 e vijues të Kodit Civil dhe në demin jopasuror të parashikuar në nenin 625/a të Kodit Civil. Konkretisht, në lidhje me demin jopasuror evidentohen figurat përbërëse të tij, që janë:

- a) **Dëmi biologjik;**
- b) **Dëmi moral;**
- c) **Dëmi ekzistencial;**

2.a Dëmtimi i shëndetit (demi biologjik) vjen si pasojë e cenimit të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Te drejtat e njeriut për jeten dhe shëndetin janë të drejta objektive që lindin dhe janë të padhunueshme e të pandashme me vete ekzistencën e tij. Prandaj te tilla ato mbrohen e garantohen si të drejta themelore të njeriut nga Kushtetuta (*neni 3, 15/1 dhe 21*). Mbrojtja e shëndetit të njeriut mëshirohet jo vetëm në detyrimin e shtetit për kujdesin shëndetësor (*neni 15/2 dhe 56*), por edhe në të drejtën për të realizuar këtë mbrojtje në gjykatë (*neni 42/2*), ndërmjet të tjerave, duke detyruar cilindo që cenon integritetin e tij fizik e psikik të dëmshpërblejë demin e shkaktuar. Ndërmjet fushave të së drejtës objektive që sanksionojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga veprimet a mosveprimet e paligjshme të të tretit, edhe në K.Civil, posaçërisht në shkronjën “a” të nenit 625, parashikohet se: *“Personi që pëson një dem, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të dëmshpërblehet kur ...a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit...”*. Dëmtimi i shëndetit, i njohur nga jurisprudenca edhe si *“demi biologjik”* apo *“demi mbi shëndetin”*, është figurë e posaçme e dëmit jopasuror dhe si i tillë, objekt kërkimi i pavarur të dëmshpërblimit përkatës. Në dallim nga demet pasurore, demi biologjik nuk ka vlerë ekonomike në tregun e lire, cenimi i tij nuk kompensohet në natyrë dhe as nuk ka çmim në të holla. Por, për efekt të mbrojtjes së shëndetit, lehtësimit dhe rehabilitimit fizik e social të dëmtuarit në të ardhmen, personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit biologjik detyrohet t’i paguaje atij një dëmshpërblim në të holla, në mënyrë të pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore që eventualisht i dëmtuari ka pësuar për shkak të njëjtij fakt të paligjshëm. Dëmtimi i shëndetit (*demi biologjik*) përben, në thelb, cenimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Ky dem jopasuror, i parashikuar nga shkronja “a” e nenit 625 të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari për shkak të njëjtij fakt të paligjshëm. Meqenëse jeta dhe shëndeti i njeriut nuk ka çmim, në respektim të parimit themeltar kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe ndalimit të diskriminimit sipas nenit 18 të Kushtetutës, gjykata duhet të garantojë një gjykim uniform dhe vlerësim të njëjte të përqindjes e të masës së dëmshpërblimit të dëmit biologjik, për çdo formë e shkalle konkrete të cenimit të përhershëm a përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të dëmtuarit, nëse mosha është e njëjte dhe po i njëjte është edhe lloji i dëmtimit shëndetësor fizik a psikik të pësuar. (*Vendimi unifikues Nr. 12, dt. 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*) Demi biologjik, duke qenë cenim në integritetin fizik dhe/ose psikik të njeriut, është objektivisht i vërtetueshëm. Prandaj, në zbatim të rregullave parimore të neneve 2, 6, 29 e vijues të K.Pr.Civile (*da mihi factum, dabo tibi ius*), i dëmtuari që kërkon dëmshpërblimin ka barrën e provës të vërtetojë se demi ka ndodhur, si dhe lidhjen shkakësore të tij me faktin e paligjshëm. Përveç kësaj, gjykata kërkon mendimin e specializuar të eksperteve në shërbim të arritjes së përfundimeve përkatëse sipas bindjes së saj të brendshme për vërtetimin ose jo të shkaktimit të dëmit biologjik, lidhjes shkakësore juridike të tij me faktin e paligjshëm, si dhe për përcaktimin e llojit dhe shkallës përkatëse të dëmtimit, në përqindje për dëmtimet e përhershme dhe në ditë për ato të përkohshme. Nga analiza në tërësi e këtyre kriterëve, referuar dhe të dhënave të provave shkresore dhe akteve të ekspertimit, ku janë përcaktuar dëmtimet në shëndetin e paditësve, llogaritjeve të bëra nga eksperti vlerësues sipas vendimit unifikues Nr. 12, dt. 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjykata çmon se paditësit duhet të dëmshpërblehet për demin shëndetësor (demin biologjik) në vlerën maksimale sipas aktit të ekspertimit.

2.b Dëmit moral, Gjykata ka parasysh përcaktimet e dhëna në Vendimin Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 të Gjykatës së Lartë, ku përcaktohet se: *“...Demi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejte (non iure perturbatio) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të tretit ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht (ius proprius) edhe secilit prej familjareve të afërt të personit që ka humbur jeten apo të cenuar në shëndetin e tij nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkëjetesës. Demi moral i pësuar nga vete të afërmit konsiderohet si pasojë, rrjedhim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të njëjtij fakt të paligjshëm...”*. Pavarësisht parimit të përgjithshëm procedural se pala që pretendon një të drejtë ka barrën e provës për ta provuar atë (*neni 12 i K.Pr.Civile*), Gjykata e Lartë ka përcaktuar se, nisur nga natyra subjektive e këtij demi dhe veçanërisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vërtetimi i cenimit të personalitetit të dëmtuarit në turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtërore, etj, nuk mund të provohet në mënyrë tjetër përveçse duke i vlerësuar *ius receptum* si të mbështetura ligjërisht dhe duke i çmuar si të provuara *ipso iure* me vërtetimin nga paditësi të vete faktit të paligjshëm të tretit dhe lidhjes së këtij fakti me cenimin moral të pësuar, sipas parimit të rregullshmërisë shkakësore. Në këto raste, i dëmtuari mund të provojë shkaktimin e dëmit moral me anë të prezumimit të thjeshtë se, sa me e afërt është lidhja gjinore familjare apo e

bashkëjetesës, aq me i rende është edhe turbullimi e dhimbja shpirtërore e te afërmit te te lënduarit apo viktimës, pra aq me e larte është shuma e dëmshpërblimit moral qe duhet t'i caktohet nga gjykata. Lidhur me masën e dëmit moral, duke qenë se kjo vlerë dëmi përcaktohet nga gjykata në bazë të bindjes së saj të brendshme, por gjithmonë duke iu referuar edhe vendimit unifikues të detyrueshëm për zbatim, vlera që do të jepet nuk duhet të konsiderohet si pasurim i pajustificuar e si i tillë kufijtë e shumës që do të përfitohet nga paditëset do të jetë shuma maksimale e përcaktuar si dëm shëndetësor nga eksperti vlerësues dëmi. Përderisa ne rastin konkret paditesit janë drejtpërdrejt të dëmtuar, pasi janë familjare të afërt, dem qe i është shkaktuar dhe vijon te ketë dhe sot pasoja, Gjykata çmon se asaj duhet tu jepet vlera maksimale e këtij dëmi te përcaktuar nga eksperti për secilin nga paditësit, konkretisht sipas aktit të ekspertimit. Ndërkohë jemi ne kushtet e lidhjes me te afërt gjinore vëllezër sipas certifikatës familjare dhe nga tërësia e ketyre rrethanave i krijon bindjen Gjykatës se atyre duhet tu caktohet vlera maksimale e dëmit moral, e cila është llogaritur nga eksperti.

2.c Dëmi ekzistencial. Vendimi Unifikues Nr.12, date 14.09.2007 i Gjykatës se Larte ka përcaktuar se: "...Dëmi ekzistencial i shkaktuar nga aksidenti, cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësime të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrave, sjelljes e zakoneve, të mardhënieve personale e familjare. Për shkak të kësaj gjendjeje psiko-fizike, të dëmtuarat, nuk mund të kryejë veprimtari që karakterizojnë pozitivisht qënien e tyre apo mund ta karakterizonin në të ardhmen, duke e detyruar të heqë dorë nga zgjedhjet dëshiruara në jetë apo nga ato të pritshmet... Shuma e dëmshpërblimit të dëmit ekzistencial, caktohet në mënyrë të pavaruar nga ai moral duke zbatuar të njëjtat kritere dhe metoda të vlefshme për llogaritjen e dëmit moral..."

Në dallim nga dëmi moral, dëm i cili është i vlerësueshëm në varësi të vuajtjes, dhimbjes së brendshme të subjektit të dëmtuar, dëmi ekzistencial ka një vlerësim të jashtëm të përkeqësimit të cilësisë së jetës. Nga ana tjetër, gjykata e lartë në vendimin e sipërcituar ka përcaktuar se ndryshe nga dëmi moral i cili mund të vërtetohet edhe nëpërmjet prezumimit të thjeshtë, në lidhje me barrën e provës për të përcaktuar nëse nga fakti i paligjshëm, është pësuar një dëm ekzistencial në dëm të paditësve (dëm në cilësinë e jetës), kjo barrë prove i nënshtrohet parimit të përgjithshëm sipas të cilës pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin që ta provojë atë. Duke pasur parasysh konkluzionin e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor sipas te cilit I ndjeri Besnik Bujaki ka ndërruar jetë, po kështu raportit vlerësues psikologjik, ku nder te tjera thuhet: "...Demi moral dhe psikologjik është i pranishëm tek paditesit..." lidhur me masën e dëmit ekzistencial, duke qenë se kjo vlerë dëmi përcaktohet nga gjykata në bazë të bindjes së saj të brendshme, bindje e cila krijohet ne bazë të provave te marra gjate gjykimi vlera që do të jepet nuk duhet të konsiderohet si pasurim i pajustificuar e si i tillë kufijtë e shumës që do të përfitohet nga paditësi do të jetë maksimal të shumës së përcaktuar si dëm shëndetësor ekzistencial te përcaktuar nga eksperti.

Në lidhje me masën konkrete të dëmshpërblimit (**Dëmi moral; Dëmi ekzistencial**) sipas Vendimi Unifikues Nr.12, date 14.09.2007 i Gjykatës se Larte, për secilin paditës gjykata i referohet aktit të ekspertimit vlerësues dëmi, i cili ka vlerësuar se: "...Kshk = Koeficienti i shumës se kapitalizuar qe i pergjigjet moshes se te dëmtuarit ne momentin e ngjarjes: Datelindja 02.05.1985, Data e vdekjes 24.02.2019. Moshja e të ndierit në momentin e ndodhjes së ngjarjes rezulton të jetë 33 vite e 09 muaj e 22 dite. Ne keto rrethana do te merret koficienti i moshes 33 vite qe percaktohen ne tabelat e miratuara nga AMF. Kshk = 22.29. Kmdp = Koeficienti i moshes se daljes ne pension. Raporti i moshes se daljes ne pension me jete gjatesine ne Shqiperi Kmdp = 1. Demi jo-Pasuror perbehet nga tre figura:1.Demi Biologjik; 2.Demi Moral; 3.Demi Ekzistencial. Demi shendetesor (Biologjik) i te ndierit Prend Ceca: 1. Dëmi biologjik përbën në thelb cënimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut dhe që ka një ndikim negativ në aktivitetin jetësor të përditshëm, në aspektin dinamik dhe ndërpersonal të jetës së palës së dëmtuar, pamvarësisht kthimit të mundshëm të kapacitetit të tij për të siguruar të ardhura. Konsiston ne cenimin e integritetit fizik dhe psikik te njeriut per shkak te ngjarjes se rende, semundjes se tij. Per percaktimin e madhësisë se demit shendetesor (biologjik) ekzistojne tabela te cilat nepermjet nje sistemi pikesh ne % percaktojne organin apo sistemin e prekur nga aksiednti, masen e demtimit fizik apo funksional te organit te prekur nga trauma. Kjo mase demtimi vleresohet nga 5 deri ne 100 %. Bazuar ne tabelat qe perdoren nga shoqerite e sigurimit demtimet qe ka pesuar i demtuari si pasoje e ngjarjes se dates 24.02.2019, perfiton dem biologjik, cenim te teresise psiko-fizike te tij ne masen 100 % e demit biologjik. Duke i konsideruar njerezit e barabarte, cka nenkupton qe per moshe te barabarte ka demtim te barabarte, demi te jete i barabarte , i njejte pavaresisht nga gjendja e tyre ekonomike, sociale etj. Te ardhurat vjetore paga T2 2019= 51,870 (paga mesatare) x 12 = 622,440 Leke. Koeficientete e tjere jane shpjeguar me siper. Demi Biologjik = Tap xKshk xKmdp = 622,440 x 22.29 x 1 = 13,874,188 leke. Demi Moral: 1. Dëmi moral është shfaqje e brendshme e turbullimit të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore individuale dhe e familjarëve të të dëmtuarit. Meqenese Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte jane shprehur per kete lloj demi i cili prezumohet nga fakti i thjeshte i ndodhjes se ngjarjes dhe ne vleresimin e tij mund te kete subjektivizem, eshte ne bindjen e brendshme te gjykates te vendose per masen e ketij demi i cili varion nga ¼ deri ne ½ e demit biologjik. Llogaritja e demit Moral: D. Moral Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke. D. Moral Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke Demi Ekzistencial: Dëmi ekzistencial është cënimi i të drejtave të personalitetit të njeriut duke dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen e të dëmtuarit si njeri, ose të familjarëve të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, si në cilësinë e jetës, ashtu dhe në marrëdhëniet personale dhe familjare. Ne piken 10 te Vendimit Unifikues te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte demi ekzistencial ose demi mbi cilesine e jetes qe shkaktohet si rrjedhoje e cenimit te vlerave komplekse te qenieve njerezore te normalitetit te cilesise dhe jetes se njeriut te fushave te ndryshme te jetes dhe solidaritetit reciprok ne kuader te familjes si dhe te shprehjes se plote te aftesive njerezore per te zhvilluar personalitetin, per t'u shfaqur dhe realizuar ne shoqeri dhe familje. Ashtu si per demin moral edhe vlera e demit ekzistencial eshte ne bindjen e brendshme te gjykates per te vendosur nga ¼ e demit biologjik deri ne ½ e demit biologjik. Llogaritja e demit ekzistencial: D. Ekzistencial Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke D. Ekzistencial Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke. Llogaritja e demit moral dhe ekzistencial per paditesat (familjaret) si pasoje e e humbjes te familjarit te tyre Prend Ceca. Aleks Ceca : D. Moral Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke D. Moral Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke D. Ekzistencial Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke D. Ekzistencial Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke. Pjerin Ceca: D. Moral Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke D. Moral Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke D. Ekzistencial Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke D. Ekzistencial Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke. Jani Ceca: D. Moral Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke. D. Moral Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke. D. Ekzistencial Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke. D. Ekzistencial Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke. Perparim Ceca: D. Moral Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke. D. Moral Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke. D. Ekzistencial Min: 13,874,188 x ¼ = 3,468,547 Leke. D. Ekzistencial Max: 13,874,188 x ½ = 6,937,094 Leke Vlera Totale e

dëmshpërblimit per te gjithë paditësit: MIN total = 27,748,376 Lekë. MAX total = 55,496,752 Lekë. Akt-Vleresimi i Demit per te ndierin Prend Ceca bazuar ne rregulloren 53 te AMF. Dëmi jo pasuror "1. Çdo personi të cilit i është shkaktuar një dëm nga përdorimi i mjetit të transportit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 22 dhe nenin 50 të Ligjit nr 10076, datë 12.02.2009, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim për dëme jo pasurore; 2. Dëmi jo pasuror përbëhet nga: a. dëm biologjik; b. dëm moral; c. dëm ekzistencial. Neni 29 Dëmi Biologjik 1. Dëmi biologjik përbën në thelb cënimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut dhe që ka një ndikim negative në aktivitetin jetësor të përditshëm, në aspektin dinamik dhe ndërpersonal të jetës së palës së dëmtuar, pavarësisht kthimit të mundshëm të kapacitetit të tij për të siguruar të ardhura. 2. Dëm biologjik përfiton personi i dëmtuar sipas shkallës së paaftësisë së përhershme i përcaktuar nga Raporti i Komisionit të ekspertëve Mjeko Ligjor, si dhe trashëgimtarët ligjore të të ndjerit në rastin me pasojë vdekje. 3. Dëmi biologjik për dëmtimin e përhershëm përcaktohet, referuar shkallës së dëmtimit dhe moshës së palës së dëmtuar dhe llogaritet për çdo 10% shkallë paaftësisë, si më poshtë: Prej moshës 30 vjeç deri në 50 vjeç c. deri në 30%.....45,000 lekë, mbi 30%.....75,000 lekë. 4. Në rastin me pasojë vdekje, trashëgimtarët ligjor të të ndjerit do të përfitojnë në mënyrë proporcionale vlerën që do të përfitonte i ndjeri në rast mbijetese sipas vlerave të mësipërme me shkallë paaftësie 100%. Perlllogaritja e demit Biologjik: Bazuar ne certifikaten e vdekjes ne momentin e aksidentit i ndjeri ka qene 33 vjec e 09 muaj e 22 dite dhe paaftesi te perhereshme 100%, bazuar ne nenet e mesiperme: Demi Biologjik= 10 x 75,000 = 750,000 leke. Demshperblimi Biologjik = 750,000 leke. Neni 30 Dëmi Moral dhe dëmi Ekzistencial 5. Vlera e dëmit moral dhe ekzistencial për paaftësinë e pjesshme të përhershme do të llogaritet për çdo 10% shkallë paaftësie në masën 100,000 lekë, nga kjo vlerë familjarët e personit të dëmtuar nuk mund të përfitojnë më shumë se 1/3 e vlerës së përfitimit. 6. Vlera e dëmit moral dhe ekzistencial që përfitojnë trashëgimtarët e të ndjerit llogaritet jo më shumë se 1/2 e dëmit moral që do të përfitonte ai dhe familjarët e tij nëse personi do të mbijetonte me paaftësi totale të përhershme. 7. Vlera e dëmit moral që përfiton personi i dëmtuar në rastin e dëmtimit total të përhershëm të shëndetit (shkalla e paaftësisë 100%), llogaritet nga 1/2 deri në dyfishin e dëmit biologjik sipas moshës përkatëse, nga kjo vlerë familjarët e personit të dëmtuar nuk mund të përfitojnë më shumë se 1/3 e vlerës së përfitimit. 8. Vlera e dëmit ekzistencial që përfiton personi i dëmtuar në rastin e dëmtimit total të përhershëm të shëndetit (shkalla e paaftësisë 100%), llogaritet nga 1/2 deri në 3/2 e dëmit biologjik sipas moshës përkatëse, nga kjo vlerë familjarët e personit të dëmtuar nuk mund të përfitojnë më shumë se 1/3 e vlerës së përfitimit. D moral + egzistencial =< 1/2 * (D moral i demtuari 100%) D moral i demtuari 100% =[1/2 * Dbiologjik ; 2 * Dbiologjik] = [1/2 * 750,000 ; 2 *750,000] = D moral i demtuari 100% =[375,000 ; 1,500,000] D moral + egzistencial =< 1/2 * (D moral i demtuari 100%) D moral + egzistencial =< 1/2 * ([375,000 ; 1,500,000]) D moral + egzistencial =< ([187,500 ; 750,000]) . Demshperblimi Moral dhe Egzistencial minimal = 187,500 leke. Demshperblimi Moral dhe Egzistencial maksimal = 750,000 leke. Totali i Demit Jopasuror minimal = 937,500 leke. Totali i Demit Jopasuror maksimal = 1,500,000 leke. Vlera e demshperblimit qe ju takon paditesave te te ndierit Prend Ceca eshte: DEMSHPERBLIMI minimal total per secilin = 937,500/4 = 234,375 leke. DEMSHPERBLIMI maksimal total per secilin = 1,500,000/4 = 375,000 leke...".

Pra, për sa më sipër në përfundim gjykata çmon se paditësit për shkak të marrëdhënies së afert vëllezër duhet të marrin dëshpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) maksimal sipas Vendimi Unifikues Nr.12, date 14.09.2007 i Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur paditësit nuk pretendojnë vlerat maksimale sipas aktit të ekspertimit, por një vlerë më të vogël se ajo që përcaktohet në këtë akt ekspertimi, gjykata bazuar në nenin 6 të K.Pr.Civile duhet të shprehet vetëm për atë që i kërkohet nga palët dhe konkretisht:

- Ø Aleks Ceca shpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) ne vleren totale 12.000.000 lekë.
- Ø Pjerin Ceca shpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) ne vleren totale 12.000.000 lekë.
- Ø Jani Ceca shpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) ne vleren totale 12.000.000 lekë.
- Ø Përparim Ceca shpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) ne vleren totale 12.000.000 lekë.

Së pesti, për sa i përket kërimit për **kamatave ligjore të vlerës së dëmit** të kërkuar edhe ky kërkim është i bazuar ne ligj dhe në prova. Përlllogaritja të bëhet gjatë fazës së ekzekutimit nga data e depozitimit të padisë deri në momentin e ekzekutimit të vendimit nga ana e shërbimit Përmbarimor, sipas normë së interesave të depozitave të Bankës së Shqipërisë.

Së gjashti, për sa i përket kërimit për dhënien e vendimit me ekzekutim te menjëhershëm/përkohshëm rezulton sipas nenit 317 të K.pr.Civile, se nga paditësit nuk u paraqitën prova shkresore që të provojnë se paditësit plotësojnë kushtet për të përfituar nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. **Ne këto kushte ky kërkim duhet rrëzuar si i pabazuar ne ligj dhe në prova.** Kundër rrëzimit të kësaj kërkesë dhe kësaj pjese të vendimit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Së shtati, referuar nenit 626 të Kodit Civil, kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen ndaj të dëmtuarit solidarisht. Në rastin në gjykim, ashtu siç u analizua dhe më sipër, dëmi i shkaktuar paditëses dhe nderhyresve kryesor, ka ardhur si rezultat i veprimt dhe mosveprimt të paligjshëm dhe me faj të palëve të paditura (OSHEE), (OSSH), (FTL); (FSHU). Në këto kushte, shpërblimi i dëmit pasuror dhe jopasuror, duhet t`u ngarkohet në mënyrë solidare ketyre palëve.

Së teti, për sa u përket shpenzimeve gjyqësore dhe atyre për vënien ne ekzekutim të vendimit, gjykata çmon se, bazuar në nenin 106 te K.Pr.Civile, ato duhet t`u ngarkohen palëve te paditura (OSHEE), (OSSH), (FTL); (FSHU). Këto shpenzime përbëhen nga shpenzimet e verifikuara, te renditura në fund të këtij vendimi, e konkretisht: taksa gjyqësore 1% e vlerës se demit të parapaguar; pagesa e e aktive te ekspertimit sipas faturës për arkëtim e parapaguara; pagesat e avokateve sipas faturave përkatëse.

Së fundi, për sa i përket ekzekutimit, bazuar në parashikimet e nenit 510/a të K.Pr.Civile, ky vendim gjyqësor përbën titull ekzekutiv, pasi të marrë forme te prere dhe duhet te ekzekutohet nga përmbarimi gjyqësor, me kërkesë te kreditorëve (paditëses dhe nderhyresve kryesor) ne rast mosekzekutimi ne mënyre vullnetare nga palët e paditura.

Për sa u përket shpenzimeve gjyqësore dhe atyre për vënien në ekzekutim të këtij vendimi, gjykata çmon se, bazuar ne nenin 106 të K.Pr.Civile, ato duhet t`i ngarkohen palëve të paditura ne masën 1/4 secili. Këto shpenzime përbëhen nga shpenzimet e verifikuara, të renditura në fund të këtij vendimi.

Në përfundim, duke pasur parasysh gjithë sa më sipër u citua, gjykata çmon se kërkesë padia e paditëses është e bazuar në ligj dhe në prova dhe duhet pranuar për pjesën që rezultoi e tille, duke rrezuar pjesën tjetër si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 608, 609, 618, 622 e vijues të K. Civil dhe 126, 306-310, 317 e vijues të K.Pr.Civile dhe Vendimit Unifikues Nr.12/2007 të Gjykatës së Lartë,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesë padis?
2. Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditësit Aleks Ceca shpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) ne vleren totale 12.000.000 (dymbëdhejtëmilion) lekë.
3. Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditësit Pjerin Ceca shpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) ne vleren totale 12.000.000 (dymbëdhejtëmilion) lekë.
4. Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditësit Jani Ceca shpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) ne vleren totale 12.000.000 (dymbëdhejtëmilion) lekë.
5. Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditësit Përparim Ceca shpërblimin e dëmit jo-pasuror (moral dhe ekzistencial) ne vleren totale 12.000.000 (dymbëdhejtëmilion) lekë.
6. Rrëzimin e kërimit për dhënien e këtij vendimi me ekzekutim të përkohshëm.
7. Shpenzimet gjyqësore I ngarkohen palëve të paditura solidarisht.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
9. Për pikën 6 të dispozitivit, për dhënien me ekzekutim të përkohshëm, mund të bëhet ankim I veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë.

U shpall sot, në Vlorë, më date 03.11.2022.

SEKRETARE
BLERINA BRAHIMI

GJYQTAR
ENKEL PEZA

Për këto arsye

Baza Ligjore:x

VENDOSI:

x

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

Enkel Peza